

VLERËSIMI I NIVELIT TË QYTETARISË DEMOKRATIKE

në edukimin formal qytetar
në Shqipëri, përmes analizës
së kurrikulës dhe objektivat
e të mësuarit të lëndëve
të edukimit qytetar, si dhe
harmonizimi i tyre me
standardet dhe praktikat
e Këshillit të Evropës

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

VLERËSIMI I NIVELIT TË QYTETARISË DEMOKRATIKE

në edukimin formal qytetar
në Shqipëri, përmes analizës
së kurrikulës dhe objektivat
e të mësuarit të lëndëve
të edukimit qytetar, si dhe
harmonizimi i tyre me
standardet dhe praktikat
e Këshillit të Evropës

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Riprodhimi i fragmenteve (deri në 500 fjalë) është i autorizuar, nëse nuk bëhet për qëllime komerciale dhe për aq kohë sa ruhet integriteti i tekstit, nuk nxirret jashtë kontekstit, nuk jep informacion të paplotë ose nuk e keqorienton lexuesin në lidhje me natyrën, objektin apo përmbajtjen e tekstit.

Përgatitur brenda fushës së zbatimit të projektit “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE	4
1. HYRJE	5
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
3. METODOLOGJIA	9
4. VLERËSIMI I EDUKIMIT PËR QYTETARI DEMOKRATIKE NË SHQIPËRI	13
4.1 Politikat dhe konteksti legjislativ	15
4.1.1 Konteksti ndërkombëtar	15
4.1.2 E drejta e edukimit për qytetari demokratike dhe e edukimit për të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ)	17
4.1.3 Politikat dhe legjislatiioni ekzistues kombëtar për EQD-në/EDNJ-në	18
4.1.4 Konteksti i EQD-së dhe EDNJ-së në sistemin arsimor në Shqipëri	20
4.2 Analiza e përmbajtjes së lëndëve përkatëse të EQD-së/EDNJ-së	22
4.3 Roli i aktorëve të ndryshëm në EQD-në dhe EDNJ-në	25
4.4 Praktikatat e mësimdhënies dhe të të nxënies	26
4.4.1 Zbatimi i kurrikulës	27
4.4.2 Qasja e mësuesve dhe përgjigjja ndaj EQD-së dhe EDNJ-së	28
4.4.3 Tekstet shkollore	30
4.4.4 Vlerësimi i arritjeve të nxënësve	37
4.4.5 Provimi i maturës shtetërore	38
4.4.6 Reflektimi, opinione dhe mendime të prindërve	39
5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	43
5.1 Përfundime	43
5.2 Rekomandime	45
6. LISTA E REFERENCAVE	47

LISTA E SHKURTIMEVE

ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ¹
BE	Bashkimi Evropian
EDNJ	Edukimi për të Drejtat e Njeriut
EQD	Edukimi për Qytetari Demokratike
IZHA	Instituti për Zhvillimin e Arsimit (sot ASCAP)
KiE	Këshilli i Evropës
KRKKD	Kuadri i Referencës për Kompetencat për Kulturë Demokratike
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

1. Kjo agjenci u themelua në vitin 2019, me urdhrin nr. 25, datë 27.2.2019, *Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të Institucionit Arsimor* (MAS, 2018-2) dhe me VKM-në nr. 98, datë 27.2.2019, *Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar* (QBZ, 2019), duke zëvendësuar Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA). Shkurtime ASCAP dhe IZHA, që përdoren në këtë tekst, u referohen të njëjtit institucion.

1. HYRJE

Projekti i Këshillit të Evropës “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri” ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e arsimit në Shqipëri, përmes forcimit të kapacitetit të sistemit arsimor për të zhvilluar kompetencat e nxënësve për kulturë demokratike, në përputhje me objektivat e politikave kombëtare dhe me standardet dhe praktikatat e Këshillit të Evropës. Duke u mbështetur në veprimtaritë e mëparshme të bashkëpunimit të Këshillit të Evropës në Shqipëri dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS), projekti mbështet reformën e vazhdueshme kurrikulare dhe qasjet e reja të arsimit, që përfshijnë arsimin me bazë kompetencat dhe metodat e mësimdhënies me në qendër studentin.

E ardhmja e shoqërisë është ngushtësisht e lidhur me arsimin që u jepet fëmijëve dhe gjithçka që u mësohet atyre në shkollë rreth të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, rreth të drejtave dhe përgjegjësive të tyre, pjesëmarrjes dhe përkatësisë, respektit për diversitetin etj. Ndaj, përmirësimi i vazhdueshëm i kapacitetit arsimor dhe, veçanërisht, i lëndëve mbi qytetarinë demokratike, ndihmon nxënësit dhe studentët të pajisjen me njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat e qytetarëve kompetentë.

Kjo analizë synon të identifikojë mënyrën e pasqyrimit të praktikave dhe të veprimtarive që përbëjnë *Edukimin për Qytetari Demokratike* (EQD) në sistemin e arsimit formal, përmes analizimit të kurrikulës që lidhet me edukimin për qytetari dhe objektivat e mësimit të lëndëve të zgjedhura (nga klasa I deri në XII), që trajtojnë edukimin për qytetari. Kjo analizë synon, gjithashtu, harmonizimin e praktikave të arsimit tonë me standardet dhe praktikatat e KiE-së, duke përfshirë Kartën e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut, Rekomandimin e Këshillit të Evropës KM/Rek. (2007)13 për barazi gjinore në arsim dhe Kuadrin e Referencës së Kompetencave të Kulturës Demokratike.

Harmonizimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri, me standardet e KiE-së, nuk i shërben vetëm shoqërisë shqiptare në tërësi, por edhe përmbushjes së qëllimit të KiE-së për të rritur unitetin mes anëtarëve të tij përmes masave në fushën kulturore dhe atë arsimore.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me Kartën², zhvillimi i politikave dhe i legjislacionit të brendshëm, por edhe zbatimi i tyre në praktikë sipas dispozitave kushtetuese, duhet të udhëhiqet nga konceptet dhe objektivat e përcaktuar në këtë dokument. Sipas kësaj qasjeje, kjo nuk vlen vetëm për përputhshmërinë me dispozitat kushtetuese dhe të legjislacionit për konceptet e edukimit për qytetari demokratike (EQD) dhe të edukimit për të drejtat e njeriut (EDNJ), por edhe për zbatimin e tyre në praktikë.

Analizimi dhe vlerësimi i gjendjes aktuale, për sa i përket nivelit të zhvillimit të qytetarisë demokratike në sistemin e arsimit parauniversitar dhe nivelit të harmonizimit të tij me Kuadrin e Referencës së Kompetencave për Qytetari Demokratike (KRQD), është kusht paraprak për planifikimin e masave efektive të ndërhyrjes për forcimin e edukimit për qytetari demokratike në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Në analizë janë marrë parasysh edhe karakteristikat e shoqërisë shqiptare, si dhe trashëgimia kulturore dhe arsimore.

Situata e qytetarisë demokratike në sistemin e arsimit parauniversitar përgjithësisht është përmirësuar. Megjithatë, ka ende shumë punë për të bërë, veçanërisht, sa i përket rritjes së rëndësisë dhe hapësirës që i kushtohet EQD-së/EDNJ-së në sistemin e arsimit, përmes përmirësimit të cilësisë së librave të lëndëve lidhur me qytetarinë demokratike, të trajnimeve të mësuesve, si dhe të forcimit të rolit dhe bashkëpunimit të të gjitha palëve të interesit të përfshira. Ngarkesa mësimore e planifikuar për vitin akademik prej 35 orësh, që i kushtohen lëndës së Qytetarisë, nuk është e mjaftueshme duke pasur parasysh tërësinë e objektivave të programit dhe të mësimit.

Kalimi te kurrikula, që bazohet në kompetenca, shënoi një ndryshim pozitiv, megjithatë, për kurrikulën e re, nevojiten mësues krijues, që ta organizojnë procesin e mësimdhënies dhe të të nxëniet në mënyrë interaktive dhe të përfshijnë sa më shumë që të jetë e mundur tema edukative në lëndë të ndryshme, veçanërisht në klasat e arsimit fillor. Mësuesit duhet ta nxisin më shumë punën në grupe ose lojën me role, por edhe veprimtaritë jashtë kurrikulës, që t'u krijojnë mundësi nxënësve për ta kontekstualizuar informacionin, njohuritë, vlerat dhe qëndrimet e marra, si individë dhe si pjesë e komunitetit.

Analiza e evidentoi disa problematika në lidhje me performancën e mësuesve, rolin e tyre në mësimdhënien e EQD-së/EDNJ-së dhe me përcjelljen e saktë të koncepteve të duhura te nxënësit. Gjithashtu, rëndësia që u kushtohet EQD-së/EDNJ-së nga shkollat, mësuesit dhe prindërit, si edhe hapësira që kanë lëndët përkatëse në programin e arsimit, nuk janë të mjaftueshme. Aktorët e sistemit të arsimit duhet t'u japin më shumë kohë, rëndësi dhe hapësirë EQD-së/EDNJ-së, në mënyrë që nxënësve t'u garantohet informim e trajnim më i mirë për jetën, që të bëhen të rritur kompetentë.

2. Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut, u miratua në kuadër të Rekomandimit KM/Rek. (2010) të Komitetit të Ministrave.

Programet mësimore dhe librat e lëndës së Qytetarisë, por edhe të lëndëve të Gjuhës shqipe, Historisë dhe Sociologjisë synojnë t'u përçojnë nxënësve konceptet e EQD-së/EDNJ-së, në mënyrë që ata të pajisen me njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat e qytetarëve kompetentë. Edhe pse ka një sërë prioritetesh për strukturën dhe përmbajtjen e lëndëve të karakterit shoqëror, vërehet një qëndrim paksa indiferent i mësuesve në lidhje me programin e këtyre lëndëve. Në procesin e zbatimit dhe të zhvillimit të kësaj kurrikule në shkollë, mësuesit mbështeten përgjithësisht te librat, pa u përpjekur të integrojnë temat e mësimdhënies së lëndëve të tjera apo të përdorin materiale të ndryshme mësimdhënieje për ta bërë procesin e mësimdhënies sa më tërheqës që të jetë e mundur.

Analiza identifikoi një gjetje interesante mbi faktin se pjesa më e madhe e autorëve të teksteve të Qytetarisë janë femra. A fshihet ndonjë arsye pas kësaj dhe a lidhet kjo me ndonjë nga problemet e identifikuara?

Pjesa më e madhe e përfundimeve të kësaj analize mund të adresohen përmes trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve. Trajnimi i mësuesve sjell rezultate të shpejta në mbushjen e boshllëqeve të objektivave të mësimin dhe, njëkohësisht, adreson pjesën më të madhe të problemeve të identifikuara.

Vlerësimi i nevojave dhe i trajnimeve të mësuesve të Qytetarisë është me përparësi të madhe, pasi do të ndihmojë në identifikimin e ndërhyrjeve që adresojnë përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënësve, si dhe do të sjellë rezultate të shpejta pozitive në shkollë. Gjashtë manualet e KiE-së për "Demokracinë në veprim", të cilët janë testuar nga arsimtarët dhe janë mjaft fleksibël për trajnimin e mësuesve, për të futur edukimin për qytetarinë dhe të drejtat e njeriut në klasat e tyre në mënyrë ndërvepruese, argëtuese, por edhe sfiduese, mund të shërbejnë si bazë shumë e mirë për zhvillimin e kurrikulës së trajnimit dhe për trajnimin e trajnuesve.

3. METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i nivelit të qytetarisë demokratike në arsimin formal qytetar, përmes analizimit të kurrikulës dhe objektivave të mësimt të lëndëve që trajtojnë edukimin qytetar në arsimin formal në Shqipëri. Raporti synon, gjithashtu, të japë rekomandimet e tij për harmonizimin e mëtejshëm me standardet dhe praktikatat e KiE-së.

Fillimisht, u zgjedhën lëndët nga klasa I deri në XI, që trajtonin edukimin qytetar në arsimin zyrtar në Shqipëri. Kriteret e përzgjedhjes së lëndëve përfshinin lidhjen me temën e qytetarisë demokratike, ngarkesën e orëve për një javë të mësimdhënies së lëndës dhe statusin e detyrueshëm të lëndës.

Edukimi për qytetari bëhet nga klasa I në klasën XI brenda disiplinave të shkencave sociale si “Shkenca dhe mjedisi”, përveç klasës X dhe XI, në të cilat Edukimi për qytetari është lëndë e detyrueshme. Kjo ishte arsyeja se pse lënda e Qytetarisë u zgjodh për analizë. Lëndët e Filozofisë dhe të Sociologjisë u zgjedhën për shkak të rëndësisë së përmbajtjes së tyre (siç do të ilustron në kërret vijues) me temën e qytetarisë demokratike.

Përzgjedhja e lëndës bazohet në kriteret e mëposhtme:

- ▶ lënda është e detyrueshme dhe jo fakultative;
- ▶ lidhjes së ngushtë me temën e qytetarisë demokratike;
- ▶ numri i orëve të mësimt në javë.

Në bazë të kriterëve të mësipërme, u propozuan lëndët e mëposhtme:

Klasa	Lënda	Kriteri	Niveli i përshtatshmërisë me qytetarinë demokratike	Nr. i orëve të mësimt
Klasa I ³	Qytetari	E detyrueshme	i lartë	35 orë në vit
Klasa II ⁴	Edukim për shoqërinë	E detyrueshme	i lartë	35 orë në vit
Klasa III ⁵	Qytetari	E detyrueshme	i lartë	35 orë në vit
Klasa IV ⁶	Qytetari	E detyrueshme	i lartë	35 orë në vit
Klasa V ⁷	Qytetari	E detyrueshme	i lartë	35 orë në vit
Klasa VI ⁸	Qytetari	E detyrueshme	i lartë	35 orë në vit

3. <https://www.ascap.edu.al/klasa-i-baze-fillor/>

4. <https://www.ascap.edu.al/klasa-ii-baze-fillor/>

5. <https://www.ascap.edu.al/klasa-iii-baze-fillor/>

6. <https://www.ascap.edu.al/klasa-iv-baze-fillor/>

7. <https://www.ascap.edu.al/klasa-v-baze-fillor/>

8. <https://www.ascap.edu.al/klasa-vi-baze-fillor/>

Klasa VII ⁹	Qytetari	E detyrueshme	i lartë	35 orë në vit
Klasa VIII ¹⁰	Qytetari	E detyrueshme	i lartë	35 orë në vit
Klasa IX ¹¹	Qytetari	E detyrueshme	i lartë	35 orë në vit
Klasa X ¹²	Qytetari	E detyrueshme	i lartë	70 orë në vit
Klasa XI ¹³	Filozofi	E detyrueshme	i lartë	72 orë në vit

Me propozimin e ASCAP-së dhe në konsultim me ekipin e projektit, lënda e Sociologjisë, që jepet në klasën XII, u bë pjesë e analizës. Faktikisht, kjo lëndë, edhe pse me zgjedhje, duket se është e vetmja lëndë që trajton kulturën dhe besimin për nga pikëpamja sociologjike. Duke marrë parasysh se ndërgjegjësimi dhe shprehja kulturore është kompetencë kyçe, propozimi u pranua dhe u adresua në një seksion të posaçëm të rekomandimeve. Në fazën e dytë, për të përmbushur qëllimin e vlerësimit, u zhvillua metodologjia kërkimore.

Metodologjia studimore ka për qëllim t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- *A përputhet niveli i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri me standardet dhe praktikatat e KiE-së?*

Veprimtaritë:

- ▶ Analiza e kurrikulës, librave dhe objektivave të mësimi të lëndëve të zgjedhura, që trajtojnë edukimin për qytetari nga klasat I–XII. Kurrikula dhe objektivat e mësimi të lëndëve të *Qytetarisë*, *Filozofisë* dhe *Sociologjisë* u vlerësuan për nga harmonizimi i tyre, me:
 - Kartën e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut;
 - Rekomandimin KM/Rek. (2010)7 dhe Kuadrin e Referencës së Kompetencave për Kulturë Demokratike;
 - Rekomandimin e KiE-së KM/Rek. (2012)13 për garantimin e arsimit cilësor;
 - Rekomandimin KM/Rek. (2007)13 për barazinë gjinore në arsim;
 - Manualin e Këshillit të Evropës për Qeverisjen Demokratike të Shkollave;
 - Manualin e Këshillit të Evropës për Mësuesit, "Demokracia në veprim";
 - Krijimi i një Evrope për fëmijët dhe me fëmijët.
- ▶ Vlerësimi i përmbajtjes, gjuhës dhe ilustrimeve të librave nga pikëpamja gjinore, duke pasur parasysh rëndësinë e barazisë gjinore dhe arsimit gjithëpërfshirës të pabazuar në stereotipa;

9. <https://www.ascap.edu.al/klasa-vii-baze-mesem-ulet/>

10. <https://www.ascap.edu.al/klasa-viii-baze-mesem-ulet/>

11. https://www.ascap.edu.al/klasa-ix-baze-mesem-ulet/?doing_wp_cron=1591355921.7689199447631835937500

12. <https://www.ascap.edu.al/klasa-x-gjimnazi-berthame/>

13. <https://www.ascap.edu.al/klasa-xi-gjimnazi-berthame/>

- *Cilat janë mangësitë dhe si mund të adresohen ato për të siguruar harmonizimin e mëtejshëm me standardet dhe praktikat e KiE-së? Cilat janë mundësitë dhe sfidat?*

Veprimtaritë:

- ▶ Identifikimi i aspekteve që nuk përputhen me standardet dhe sfidave për përmirësimin e gjendjes;
- ▶ Rekomandimi i ndërhyrjeve më të realizueshme që garantojnë përputhshmërinë e mëtejshme me standardet dhe me praktikat e KiE-së.

Për të përmbushur objektivat e synuar, u përdorën metoda të kombinuara, që përfshijnë studimin me bazë shqyrtimin e dokumentacioneve dhe intervistat me aktorët kyç. Studimi me bazë shqyrtimin e dokumentacioneve përbëhej nga analizimi i studimeve të mëparshme, dokumenteve të referencës dhe librave të lëndës së Qytetarisë që zhvillohet nga klasa I–X, të lëndës së Filozofisë që zhvillohet në klasën XI dhe të Sociologjisë që zhvillohet në klasën XII. Studimi i dokumenteve të KiE-së, që siguron standardet e nevojshme për vlerësimin e nivelit të edukimit për qytetari demokratike dhe vizionin për forcimin e qytetarisë demokratike, shërbeu për hartimin e standardeve dhe praktikave përkundrejt të cilave u analiza dhe u vlerësua kurrikula dhe objektivat e mësimin.

Metodat e analizimit të përmbajtjes u përdoren për të kuptuar më thellë objektivat e mësimin, strukturës, qëllimit, përmbajtjes dhe epistemologjisë së kurrikulës së Qytetarisë, Sociologjisë dhe Filozofisë. Analiza e përmbajtjes, që u krye përmes kësaj metodologjie, adresoi njëkohësisht nevojën për shqyrtimin sistematik të kurrikulës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit në lidhje me objektivat e mësimin, si dhe me përvojat e mësimin të nxënësve.

Komunikimi, konsultimi dhe shkëmbimi me palët e interesit u krye mes aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë zyrtarë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, mësues që merren me lëndën e EQD-së dhe autorë të teksteve të Qytetarisë, si dhe prindër e nxënës të arsimit fillor dhe atij të mesëm.


Përmes metodave të kombinuara të komunikimit, u realizuan tridhjetë e pesë intervista me ekspertë të arsimit, autorë librash dhe prindër. Për shkak të pandemisë së COVID-19 dhe pushimeve verore të shkollave, aty ku ishte e mundur, komunikimi u zhvillua nëpërmjet takimeve, veçanërisht me ekspertët e arsimit dhe me mësuesit e lëndëve të arsimit fillor. Komunikimi me prindërit u realizua përmes pyetësorëve *online*, për realizimin e të cilëve ndihmuan vetë mësuesit.

Rezultatet e vlerësimin të gjendjes aktuale të edukimit për qytetari demokratike dhe analizimi i kurrikulës, do t'i drejtojnë ndërhyrjet në nivel kurrikular, përmes përmirësimin të lëndëve përkatëse të edukimit qytetar, por edhe në nivel politikash.

4. VLERËSIMI I EDUKIMIT PËR QYTETARI DEMOKRATIKE NË SHQIPËRI

Analiza e përbajtjes së objektivave të mësimin bazohet në Kuadrin e Referencës për Kompetencat për Kulturë Demokratike (KRKKD). KRKKD-ja përbëhet nga një grup materialesh, që mund të përdoret nga politikëbërësit në fushën e arsimit, si dhe nga profesionistët e të gjithë sektorëve të sistemit të arsimit për t'i pajisur të rinjtë me aftësitë e duhura për t'u bërë qytetarë me kompetenca demokratike dhe ndërkulturore. Ai përfshin jo vetëm mësimdhënien dhe të nxëniet në klasë, por edhe përvojat praktike të përftuara gjatë jetës shkollore dhe aktiviteteve në shoqërinë e gjerë. Modeli konsiston në njëzet kompetenca, të cilat ndahen në katër fusha: *vlerat, qëndrimet, aftësitë dhe njohuritë*¹⁴. Kompetencat janë përmbledhur në diagramin e mëposhtëm (fig. 1).

Figura 1



14. Arsyetimi që qëndron në modelin e kompetencës, dhe procesi përmes të cilit këto kompetenca të veçanta u identifikuan, përshkruhen plotësisht në: Këshilli i Evropës (2016), Kompetencat për Kulturën Demokratike: të jetuarit së bashku si të barabartë në shoqëritë demokratike të larmishme kulturore, Publikimi i Këshillit të Evropës, Strasburg.

Analiza u zhvillua në bazë të parimeve të mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe përgjegjësisë publike për të garantuar arsim cilësor dhe u drejtua nga objektivat dhe konceptet e dhëna në Kartën e KiE-së për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut¹⁵.

Për qëllime të kësaj analize, koncepti *Edukimi për Qytetari Demokratike* do të ketë kuptimin e mëposhtëm, siç përcaktohet në Kartën e KiE-së për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut dhe në ligjin për arsimin parauniversitar në vendin tonë:

■ **Edukimi për Qytetari Demokratike** nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informimin, praktikat dhe veprimtaritë që këto synojnë përmes pajisjes së nxënësve me njohuri, aftësi dhe duke zhvilluar qëndrimet dhe sjelljet e tyre, që i aftësojnë dhe i fuqizojnë për të ushtruar dhe për të mbrojtur të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri, për të vlerësuar diversitetin dhe për të luajtur një rol aktiv në jetën demokratike, për mbrojtjen dhe përparimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës¹⁶.

■ **Edukimi për të Drejtat e Njeriut** nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informimin, praktikat dhe veprimtaritë që këto synojnë, përmes pajisjes së nxënësve me njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe sjellje që i aftësojnë dhe i fuqizojnë ata për të dhënë ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe mbrojtjen e një kulture universale të të drejtave të njeriut në shoqëri, për përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore¹⁷.

■ **Arsimi formal** nënkupton arsimimin e strukturuar dhe sistemin e trajnimit nga niveli i arsimit parashkollor në atë fillor, të mesëm e deri në arsimin universitar. Si rregull, *arsimi formal* përfshin institucionet e arsimit të përgjithshëm ose profesional dhe shoqërohet me certifikim¹⁸.

■ **Arsimi joformal** nënkupton çdo program të planifikuar arsimimi, jashtë mjediseve të *arsimit formal*, të hartuar për të përmirësuar një grup të caktuar aftësish dhe kompetencash¹⁹.

■ **Kurrikula** është një sistem dijesh i përbërë nga disa elemente, si: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë, programet mësimore, vlerësimi, të cilat, të lidhura mes tyre, lejojnë që sistemi arsimor të orientohet dhe të funksionojë nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula siguron arsimim cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjinore dhe pozita shoqërore²⁰.

15. Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut u miratua në kuadër të Rekomandimit KM/Rek. (2010)7 të Komitetit të Ministrave.

16. Po aty.

17. Po aty.

18. Po aty.

19. Po aty.

20. Ligji nr. 56/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 'Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë'".

■ **Kurrikula bërthamë** është kurrikula e përbashkët për të gjithë nxënësit e një niveli në sistemin arsimor²¹.

■ **Programi mësimor** është dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënit, metodologjitë e të nxënit dhe të vlerësimit për një lëndë ose për një fushë të caktuar²².

■ **Tekst shkollor** është teksti që përdoret në procesin e të nxënit, si një nga burimet e dijes dhe të informacionit, në format të printuar dhe/ose digjital, i hartuar sipas kërkesave të programit mësimor të një fushe të nxëni, nga botues privatë dhe institucione publike me të drejtë botimi, i certifikuar nga ministria përgjegjëse për arsimin²³.

Kompetenca themelore – kompetenca, për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje shoqërore dhe për punësim²⁴.

4.1 POLITIKAT DHE KONTEKSTI LEGJISLATIV

4.1.1 Konteksti ndërkombëtar

Shumë dokumente dhe instrumente ndërkombëtare përfshijnë dispozitat mbi EQD-në dhe EDNJ-në, të cilat theksojnë rëndësinë e mësimdhënies dhe të arsimit për promovimin e të drejtave të njeriut, të lirive, të drejtave demokratike dhe qytetare, të demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, si dokument historik dhe shembull i gjallë i përmasës universale të të drejtave dhe lirive të njeriut, pavarësisht sfonteve të ndryshme ligjore dhe kulturore të hartuesve dhe shteteve anëtare, vë theksin mbi mësimdhënien dhe arsimin si kusht paraprak për promovimin e respektimit të të drejtave dhe të lirive. Teksa adreson të drejtën për arsim, dokumenti tregon qartë se *arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe duhet të nxisë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve*²⁵.

Gjithashtu, *Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor* bën thirrje për *masa efikase dhe të menjëhershme, veçanërisht në fushën e mësimdhënies, arsimit, kulturës dhe informatikës, duke synuar luftimin e paragjytimeve dhe promovimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe miqësisë*²⁶. Në mënyrë më të hollësishme, *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore*, flet nga perspektiva e të drejtave shoqërore, kulturore dhe ekonomike dhe në kuadër të së drejtës së gjithsecilit për arsim, duke shtjelluar drejtimin dhe ambicien e arsimit drejt

21. Ligji nr. 56/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

22. Po aty.

23. Po aty.

24. Po aty.

25. Paragrafi 2, i nenit 26, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

26. Neni 7 i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

zhvillimit të personalitetit, por edhe drejt aftësimit të gjithsecilit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një shoqëri të lirë²⁷.

Në lidhje me parimin e barazisë gjinore, *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave* u bën thirrje shteteve palë, që të marrin të gjitha masat e duhura, për eliminimin e diskriminimit ndaj grave, duke dhënë edhe udhëzimet për mënyrën e arritjes së këtyre objektivave. Përkatësisht, paragrafi "C", i nenit 10, sugjeron: *eliminimin e çdo koncepti stereotip për rolin e burrit dhe të gruas në të gjitha nivelet dhe në të gjitha format e arsimit, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe tipa të tjerë të arsimit, që ndihmojnë realizimin e këtij objekti, sidomos, duke rishikuar tekstet dhe programet mësimore dhe duke përshtatur metodat e mësimdhënies*.

Duke pasur parasysh se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri, duke zotëruar dhe përcjellë vlerat e lirisë, të dinjitetit, solidaritetit, barazisë dhe paqes, Konventa për të Drejtat e Fëmijës parashikon që arsimimi i fëmijës të orientohet drejt zhvillimit të respektit për të drejtat e njeriut, për familjen, për identitetin kulturor të cilit i përket, duke përfshirë gjuhën dhe vlerat, si dhe respektin për qytetërimet e tjera²⁸.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi Ndryshe kërkon, si detyrim të përgjithshëm, nga shtetet palë *që të marrin në konsideratë mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të personave me aftësi ndryshe në të gjitha politikat dhe programet*²⁹. Ajo sugjeron edhe masat për luftimin e stereotipave, paragjyqimeve dhe praktikave të dëmshme përmes *nxitjes së mendësisë së respektit për të drejtat e personave me aftësi ndryshe në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, duke përfshirë të gjithë fëmijët që në moshë të hershme*³⁰.

Aderimi dhe ratifikimi i dokumenteve ndërkombëtare të mësipërme e bëjnë Shqipërinë përgjegjëse për përputhshmërinë me standardet për mbrojtjen dhe promovimin e qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut, si dhe për përfshirjen e masave të sugjeruara në këtë drejtim në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të metodave dhe përmbajtjes së mësimdhënies e të nxënit.

Në nivel evropian, Shqipëria ka nënshkruar *Kartën e Këshillit të Evropës për Qytetarinë Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut* dhe raporton mbi zbatimin e saj, rregullisht. Për nga perspektiva e integritimit evropian, Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me Shqipërinë bazohet në angazhimin e palëve për respektimin e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe parimeve demokratike mbi themelin e vlerave evropiane për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, shtetin e së drejtës dhe respektin për të drejtat e njeriut, të cilat janë mirëmenduar nga Traktati për Bashkimin Evropian si të pacenueshme dhe të patjetërsueshme.

27. Neni 13 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore.

28. Neni 29 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

29. Neni 4 i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

30. Neni 8, po aty.

4.1.2 E drejta e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ)

E drejta për EQD/EDNJ garantohet në mënyrën e duhur sipas të drejtave dhe parimeve të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin kombëtar për fëmijët dhe arsimin. Kushtetuta adreson të drejtën e gjithsecilit për arsim dhe të drejtën për ndjekjen falas të arsimit parauniversitar në shkollat publike.

Detyrimi i sistemit arsimor për ta ushqyer vetveten me vlerat dhe parimet e EQD-së/EDNJ-së buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si themel për respektimin dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, të drejtave dhe lirive, trashëgimisë kombëtare, bashkëjetesës fetare dhe bashkëjetesës me minoritetet, të cilat janë baza e shtetit³¹. Kushtetuta deklaron se *të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe organeve të pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të kontribuojnë në realizimin e tyre*³². Konceptet e EQD-së jo vetëm që janë përfshirë, por edhe japin kontribut të drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave sociale.³³

Sa u përket të drejtave të fëmijëve, ligji³⁴ për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve parashikon zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, i cili përcakton të drejtën e çdo fëmije për të pasur një zhvillim të shëndetshëm mendor, moral, shpirtëror e zhvillim social, si dhe të drejtën për t'u informuar e për të marrë arsimin e duhur.

E drejta për arsimim është rregulluar jo thjesht si e drejta për akses dhe për frekuentim të arsimimit falas e cilësor, por në ligj, gjithashtu, parashikohen edhe përgjegjësitë e qarta të prindit dhe të ministrit përgjegjës për arsimin, që t'u sigurojnë këtë të drejtë të gjithë fëmijëve pa diskriminim. Konkretisht, MAS-i ka detyrim të angazhohet në mënyrë aktive dhe merr masa konkrete për garantimin e aksesit në arsimim për të gjithë fëmijët, të organizojë plane mësimore të veçanta për fëmijët që nuk arrijnë nivelet e duhura, që synon programi mësimor dhe mbikëqyr të drejtën e fëmijës për t'u argëtuar dhe për të marrë pjesë në veprimtari kulturore e artistike.

E drejta për arsimim rregullohet shprehimisht edhe në ligjin për arsimin parauniversitar. Parimet e përgjithshme të këtij ligji³⁵ përfshijnë si parim parësor interesin e nxënësit, respektimin dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, në përgjithësi, dhe të drejtat e fëmijëve, në veçanti, parimin e gjithëpërfshirjes, të drejtën e arsimit cilësor dhe të mundësive të barabarta, ofrimin e përkujdesjes së posaçme për fëmijët me aftësi ndryshe dhe për ata me vështirësi në të nxënë.

Duke qenë se konceptet, parimet dhe praktikat e EQD-së/EDNJ-së janë pjesë e kurrikulës bërthamë dhe pasqyrohen në lëndë të ndryshme sociale dhe kryesisht në lëndën e Qytetarisë, mundësia e edukimit të EQD-së/EDNJ-së i ofrohet çdo personi në përputhje me të drejtën për arsimim.

31. Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

32. Neni 15 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

33. Neni 59 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

34. Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve".

35. Neni 6, i ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

4.1.3 Politikat dhe legjislacioni ekzistues kombëtar për EQD-në/EDNJ-në

Në përputhje me rekomandimin e KiE-së,³⁶ për qeveritë e shteteve anëtare për ta vendosur EQD-në si objektivin parësor të politikëbërjes dhe reformave arsimore, Shqipëria është angazhuar në analizimin dhe përditësimin e politikave dhe kuadrit të saj ligjor.

Për këtë, ndryshimet e bëra në vitin 2015³⁷ në ligjin për arsimin parauniversitar, parashikojnë një sistem arsimit parauniversitar me objekt të mirëpërpunuar drejt perspektivave të reja të të nxënësve që lidhen më qartë me konceptet dhe kompetencat e kulturës demokratike.

Qëllimi i sistemit të arsimit parauniversitar është krijimi i kushteve dhe mundësive, që nxënësit të krijojnë dhe të zhvillojnë dijet, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat e një shoqërie demokratike, ndër të tjera, përmes përvetësimit të vlerave kulturore dhe qytetare dhe zhvillimit të përgjegjësive ndaj vetes së tyre, shoqërisë dhe mjedisit.

Për t'iu përgjigjur qëllimit të sistemit parauniversitar, u ristrukturua edhe lista e kompetencave themelore,³⁸ duke projektuar qytetarë të informuar, përgjegjës, mendjehapur, të aftë, kritikë, të respektueshëm, bashkëpunues, pjesëmarrës dhe aktivë. Meqë pothuajse të gjitha kompetencat themelore i shërbejnë dijes dhe të kuptuarit, si dhe vlerave të duhura për qytetari demokratike, të gjithë nxënësit, që nesër do të jenë të rritur, kanë mundësinë e përvetësimit të kompetencave bazë të qytetarisë demokratike, pavarësisht moshës, nivelit të arsimit ose profesionit. Në përputhje me ligjin për arsimin parauniversitar, sistemi arsimor duhet të ndërmarrë veprimet dhe vendimet e duhura për krijimin e kushteve dhe mundësive me qëllim përmbushjen e objektivave të përcaktuar në ligj, për sistemin arsimor dhe për nxënësit.

Miratimi i Strategjisë aktuale për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2014–2020³⁹ synonte, ndër të tjera, përmirësimin e mëtejshëm të sistemit arsimor për të garantuar gjithëpërfshirjen dhe mundësi të barabarta në arsim për të gjithë. Strategjia paraqet prioritetet arsimore kombëtare gjatë periudhës së referuar dhe synon të përmirësojë sistemin e arsimit në përputhje me prirjet evropiane dhe ndërkombëtare në këtë drejtim. Modernizimi dhe reforma e sistemit arsimor u përqendrua në tri drejtime kryesore, si: krijimi i platformës për përfshirjen sociale; përfshirja e kurrikulës së bazuar në kompetenca, e cila do t'i pajisë nxënësit me aftësitë e duhura për jetën; përmirësimi i arsimimit të mësuesve. Në vitin 2014, Shqipëria miratoi Kornizën Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar, e cila shënon shkëputjen e madhe nga kurrikula me bazë përmbajtjen.

Korniza kurrikulare është hartuar në gjashtë faza kyçe kurrikulare, që përfaqësojnë periudha me karakteristika të përbashkëta sa i përket zhvillimit të fëmijëve dhe

36. Rekomandimi Rek. (2002)12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për edukimin për qytetari demokratike.

37. Ligji nr. 56/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 69/2012 'Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë'".

38. Po aty.

39. VKM-ja nr. 11, datë 11.1.2016 "Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për Periudhën 2014–2020".

kritereve kurrikulare. Ato përbëjnë pikat kryesore të referencës për përcaktimin e kompetencave kyçe që duhen zotëruar, ecurinë e nxënësve dhe kriteret e përmbushjes, organizimin e përvojave të të nxënësve, aksesin dhe kriteret e vlerësimit, si dhe specifikimin e institucionit përgjegjës për realizimin e tyre.

Duke iu referuar koncepteve dhe praktikave të EQD-së dhe EDNJ-së, dokumenti i strategjisë synon përmbushjen e objektivit të të nxënësve cilësor dhe gjithëpërfshirës përmes kurrikulës me bazë kompetencat dhe përmirësimit të teksteve shkollore; rritjen e numrit të regjistrimeve të fëmijëve të grupeve vulnerabël; shtimin e shërbimeve këshilluese dhe mbështetëse për nxënësit me qëllim rritjen e potencialit të tyre arsimor dhe zhvillimor; si dhe përfshirjen e konceptit “Shkolla si qendër komunitare”. Qëllimi i nismës “Shkolla si qendër komunitare”, e cila nisi në vitin 2014, ka të bëjë me përfshirjen e komuniteteve në krijimin e mjediseve shkollore miqësore për fëmijët dhe zgjerimin e rrjetit shkollor. Rrejtja e shkollave, si qendra komunitare, ka treguar rezultate të kënaqshme në komunitete, si në sjelljen e modeleve pozitive e zhvillimin e vlerave demokratike të fëmijët, ashtu dhe në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijët në nevojë⁴⁰.

Pas vlerësimit të Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar⁴¹ dhe në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e dhëna, si dhe duke adresuar udhëzimet dhe duke reflektuar mbi reformat e planifikuara në sistemin arsimor, është ngritur një grup pune për krijimin e një strategjie të re.

Një tjetër dokument i rëndësishëm mbi politikat për EQD-në/EDNJ-në, është Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut⁴². Në një seksion të posaçëm të këtij dokumenti trajtohet edukimi ligjor në përputhje me nevojat e grupeve të veçanta, duke përfshirë të miturit, pjesëtarët e komuniteteve romë dhe egjiptiane, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe grupet e tjera që u rrezikohet ushtrimi i të drejtave.

Sipas objektivit strategjik 4, pasurimi i kurrikulës mësimore me krerë dhe seksione të veçanta informuese që fuqizojnë nxënësit me dije dhe kulturë ligjore, ishte planifikuar të realizohej brenda vitit 2020. Gjithashtu, ky objektivi parashikon njëkohësisht edhe hartimin e moduleve të reja për trajnimin në punë të mësuesve për sa i përket edukimit të fëmijëve dhe pajisjen e tyre me kulturë ligjore, fuqizimin e tyre nëpërmjet informimit për të drejtat e tyre dhe për strukturat/autoritetet në mbrojtje të tyre dhe pasurimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare me elemente të edukimit ligjor. Brenda vitit 2021 pritet të realizohet organizimi i trajnimit të mësuesve, sipas modulit të miratuar.

Edukimi ligjor i fëmijëve është adresuar nga Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020, përmes përmirësimit të kurrikulës, si dhe nga Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2018–2021, përmes informimit dhe edukimit ligjor.

Edhe nga perspektiva e *Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm* ose siç referohen ndryshme, Agjenda 2030, EQD-së/EDNJ-së kontribuojnë në realizimin e disa prej objektivave dhe synimeve, veçanërisht të objektivit 4, “Edukimi cilësor”; objektivi 5, “Barazia gjinore”; objektivi 10, “Reduktimi i pabarazisë”; objektivi 16, “Paqja dhe

40. Vlerësimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014–2020, MAS, mbështetur nga UNICEF-i.

41. Po aty

42. Vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 47/2019 “Për miratimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut”.

drejtësia” dhe objektivi 11, “Qytete dhe komunitete të qëndrueshme”. Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar rezolutën që konfirmon angazhimin e Shqipërisë ndaj Agjendës 2030. Objektivi për edukimin cilësor parashikon se brenda vitit 2030 *do të garantohet përftimi, nga ana e nxënësve, i dijeve dhe i aftësive të nevojshme për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë, ndër të tjera, përmes edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe për mënyrë jetese të qëndrueshme, të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, promovimit të një kulture paqeje dhe pa dhunë, qytetërimit global, vlerësimit të diversitetit kulturor dhe i kontributit të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm.*

Treguesit për këtë objektivi do të masin shkallën në të cilën: i) edukimi për qytetari globale; dhe ii) edukimi për zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, janë përfshirë në të gjitha nivelet në: a) politikat kombëtare për arsimin; b) kurrikula; c) arsimimin e mësuesve; dhe d) vlerësimin e nxënësit⁴³.

4.1.4 Konteksti i EQD-së/EDNJ-së në sistemin arsimor në Shqipëri

Duke iu referuar kontekstit ndërkombëtar dhe atij kombëtar e, në veçanti, Kuadrit të Referencës së Kompetencave për Kulturë Demokratike, kjo analizë paraqet tablonë e përgjithshme të gjendjes së *edukimit për qytetari demokratike* dhe *edukimit për të drejtat e njeriut* në sistemin arsimor në Shqipëri dhe shfaq aspektet që duhen përmirësuar apo që kanë nevojë për të ndërhyrë me masa konkrete në përfshirjen e tyre në sistemin arsimor shqiptar.

Në kuadër të objektivave dhe detyrimeve të lindura prej kuadrit ligjor dhe politikave, përfshirë ato që lindin nga dokumentet ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si dhe në kuadër të detyrimeve politike që lindin nga angazhime të tjera, të tilla si: nënshkrimi i Kartës së KiE-së për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (2010), MAS-i ka qenë gjithmonë i përkushtuar për rritjen e nivelit të reflektimit dhe për përmirësimin e zbatimit të koncepteve dhe praktikave të EQD-së dhe të EDNJ-së.

Veprimtaria dhe planet e MAS-it kanë pasqyruar dinamikën e zhvillimeve politike dhe sociale, të materializuara në urdhra dhe udhëzime të ndryshme që u përgjigjen sfidave, që zhvillime të tilla kanë paraqitur në sistemin arsimor. Lista e gjatë e çështjeve që janë bërë prioritet për sistemin arsimor përfshin edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut; edukimin kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit; edukimin për fenë dhe çështjet e lidhura me të; edukimin për medien dhe informacionin; edukimin ligjor të publikut; edukimin gjinor; edukimin kundër diskriminimit; edukimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore; edukimin kundër abuzimit seksual dhe edukimin nga pikëpamja e përfshirjes.

Adresimi i këtyre çështjeve në shkolla, për aq sa ka qenë i mundur dhe në përputhje me hapësirën e lejuar nga fushat lëndore ose kurrikulare, është bërë përmes kurrikulës ose përmes trajnimit të mësuesve. Megjithatë, ato vazhdojnë të jenë përparësi dhe pjesë e përpjekjeve dhe planeve të ardhshme të punës, me qëllim që të bëhen pjesë përbërëse e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve në të gjithë sistemin arsimor⁴⁴.

43. Analiza e situatës së arsimit në Shqipëri: Drejt OZHQ4 – Arsimi 2030, UNESCO, 2018.

44. Informacion i mbledhur përmes komunikimit me zyrtarë të MAS-it dhe të ASCAP-së.

Edukimi për Qytetari Demokratike dhe Edukimi për të Drejtat e Njeriut janë pjesë e politikës arsimore në Shqipëri, në kuadër të përmbushjes së objektivit të tij bazë, për krijimin e një kulture demokratike dhe për pajisjen e individëve me kompetencat e duhura për kulturën demokratike. Kompetencat për kulturë demokratike, si pjesë e KRKQD-së, mbështesin të gjithë kurrikulën e edukimit për qytetari, e cila është pjesë e kurrikulës zyrtare të arsimit parauniversitar nga klasa I deri në klasën X. Këto kompetenca përbëjnë bazën e përmbajtjes së lëndës së *Qytetarisë*. Ato shprehen dhe nënkuptohen qartë në fushat, përmasat, idetë, konceptet dhe objektivat e kësaj kurrikule, të cilat janë harmonizuar horizontalisht dhe vertikalisht me standardet dhe praktikatat e KIE-së.

Kurrikula ndërtohet në përmasa të ndryshme: politike, ligjore, duke përfshirë të drejtat e njeriut, përmasat sociale, ekonomike, kulturore dhe ato fetare, globale etj. Ajo çfarë nxënësit duhet të dinë dhe duhet të jenë në gjendje të bëjnë deri në fund të çdo niveli shkollor të arsimit parauniversitar, për sa u përket dijeve, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave, paraqitet qartësisht në programin mësimor të çdo viti shkollor.

Megjithatë, temat, objektivat dhe çështjet e lidhura me KRKQD-në janë përfshirë ose janë pjesë e gjithë kurrikulës shkollore dhe, veçanërisht, në lëndët e shkencave shoqërore, si: Histori, Gjeografi (arsimi i mesëm i ulët) dhe Sociologji, Filozofi, Ekonomi (arsimi i mesëm i lartë).

Kurrikula është unifikuar në nivel kombëtar, pra të gjithë nxënësit kanë të njëjtën kurrikulë. Vlen të përmendet fakti i tri niveleve për kriteret e performancës (bazë, mesatar dhe i përparuar), me shembuj treguesish për secilin nivel dhe të zhvilluar e të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Këto kritere të unifikuara shërbejnë jo vetëm që vlerësimi të jetë i drejtë, por edhe të shërbejnë si mekanizma për zbatimin e vetë kurrikulës. Mësuesit janë të detyruar të japin më të mirën për nxënësit e tyre, me qëllim që nxënësit të arrijnë rezultatet e të nxënit në përputhje me nivelet e përparuara të aftësive të të menduarit. Ata duhet t'u japin mundësi nxënësve të tregojnë nivelin e tyre të arritjeve. Mësuesit duhet të jenë të kualifikuar që të mund t'i përmbushin kriteret e kurrikulës e të vlerësimit.

Në Kornizën Kurrikulare Kombëtare për Arsimin Parauniversitar, edukimi për qytetari; edukimi për të drejtat e njeriut; edukimi ndërkulturor; edukimi mjedisor, shëndetësor dhe i qëndrueshëm etj. janë pjesë e temave ndërdisiplinore që duhen përfshirë, aty ku është e mundur, në të gjitha lëndët, por, në veçanti, në lëndët e Sociologjisë, Filozofisë, Historisë, Gjeografisë, Gjuhës shqipe, si edhe në lëndë të tjera, si: Kimi, Biologji etj.

Lënda e Qytetarisë ka zëvendësuar lëndën Edukimi moral dhe politik, që ishte pjesë e sistemit arsimor në periudhën e para viteve '90 në Shqipëri. Përmbajtja e lëndës së Qytetarisë përfshin njohuri, të dhëna e dukuri, problemet dhe sfidat përkatëse jo vetëm të realitetit shqiptar – i cili është ende në proces ndryshimi – po edhe të realitetit dhe përvojave botërore në fushën e edukimit qytetar. Si e tillë, kurrikula e kësaj lënde është përballur vazhdimisht me sfidën e ballafaqimit dhe ndryshimeve në faktorët vendorë, ekonomikë, shoqërorë, kulturorë dhe psikologjikë, por edhe me perspektivën e angazhimit të vendit për integrim dhe për anëtarësimin e tij të ardhshëm në BE. Ky angazhim duhet të pasqyrohet në mënyrën e duhur në të gjithë sistemin arsimor, në lëndën e Qytetarisë dhe në lëndë të tjera të lidhura me edukimin për qytetarinë demokratike.

Në përgjithësi, ndryshimet e përshtatura në kurrikul shënojnë progres dhe janë në përputhje me politikat dinamike të KiE-së të njëzet vjetëve të fundit. Kurrikula e shkruar pasqyron konceptet dhe praktikën e përditësuara të dokumenteve të KiE-së.

4.2 ANALIZA E PËRMBAJTJES SË LËNDËVE PËRKATËSE TË EQD-së/EDNJ-së

Konceptet e edukimit për qytetari demokratike dhe të edukimit për të drejtat e njeriut përbëjnë themelet e përmbajtjes së kurrikulës së lëndës së Qytetarisë. Kurrikula e Qytetarisë bazohet në metodën shumëdimensionale, e cila përfshin:

- ▶ **Dimensionin politik** – pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes dhe në ushtrimin e pushtetit politik;
- ▶ **Dimensionin ligjor** – vetëdijësi dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve;
- ▶ **Dimensionin kulturor** – respekti për të gjithë njerëzit, për vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët e njëkohësisht edhe të ndryshme, si dhe nevoja për ngritjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore;
- ▶ **Dimensionin social dhe ekonomik** – veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës, zhvillimit të komunitetit dhe kontributit të ekonomisë në krijimin e një shoqërie demokratike;
- ▶ **Dimensionin evropian** – ndërgjegjësi për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe mësimi i të jetuarit në kontekstin evropian;
- ▶ **Dimensionin global** – njohja, pranimi dhe promovimi i ndërvarësisë dhe solidaritetit global.

Qëllimi i deklaruar i kurrikulës, është:

- ▶ të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, nëpërmjet fuqizimit të kulturës demokratike;
- ▶ të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- ▶ të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe të mirën e përgjithshme;
- ▶ të fuqizojë shoqërinë civile, përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike.

Përveç kuptimit të koncepteve dhe vlerave bazë, si dhe përftimit të aftësive themelore të jetës, kurrikula ekzistuese e Qytetarisë përfshin ose u referohet edhe koncepteve të tjera të mëposhtme, të cilat lidhen me qëndrimet drejt demokracisë, të tilla si:

- ▶ përkushtimi ndaj parimit të universalitetit, të ndërvarësisë dhe të pandashmërisë së të drejtave të njeriut dhe të lirisë themelore;
- ▶ bindja për vlerën, dinjitetin dhe lirinë e individit;
- ▶ përkushtimi ndaj shtetit të së drejtës, drejtësisë, barazisë dhe paanësisë;

- ▶ përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore;
- ▶ bindja për vlerën dhe domosdoshmërinë e parimeve, institucioneve dhe procedurave demokratike, si dhe për rëndësinë e veprimit qytetar;
- ▶ respektimi i kulturave të tjera dhe i kontributit për njerëzimin;
- ▶ pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme;
- ▶ përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjytimeve dhe çdo forme të diskriminimit;
- ▶ bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë vetjake;
- ▶ përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, duke pasur parasysh ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.

Gjatë viteve të fundit, konceptet kurrikulare të edukimit ndërkulturor, të edukimit fetar në kontekstin e mësimit të botëkuptimeve fetare dhe jofetare, qytetarisë globale së bashku me çështjet kundër ekstremizmit të dhunshëm e radikalizimit janë shtuar në përmbajtjen e lëndës së Qytetarisë.

Në bazë të objektivave të saj, lënda e Filozofisë, e cila mësohet në klasën XI, përmbush një pjesë të mirë të kriterëve për pajisjen e nxënësve me aftësi qytetare që, në një mënyrë ose një tjetër, përfshihen në Kuadrin e Referencës së Kompetencave për Kulturë Demokratike. Programi mësimor i lëndës së Filozofisë synon, ndër të tjera, t'u ofrojë nxënësve aftësi për të zgjidhur probleme; për të organizuar ide dhe çështje të ndryshme; për t'i komunikuar idetë e tyre; për t'i paraqitur ato përmes argumenteve të mirëstrukturuara dhe sistematike; për të shprehur e mbrojtur një qëndrim të caktuar me argumente; për të krijuar dhe mbrojtur një pikëpamje; për të formuluar hipoteza; për të bërë kërkime; për të shtruar një problem me qëllim identifikimin e zgjidhjes së tij; për të kërkuar, kuptuar dhe trajtuar të gjitha problemet e jetës; për të kuptuar lidhjen e filozofisë me dijet dhe veprimtaritë e tjera njerëzore, si dhe të pajisë nxënësit me aftësi për pjesëmarrje qytetare në zgjidhjen praktike të problemeve të ndryshme dhe për të zgjedhur një qëndrim të caktuar filozofik e moral në funksion të angazhimit në jetën e tyre sociale.

Sa i përket kompetencës së të menduarit të pavarur, nxënësi duhet të jetë në gjendje të krijojë dhe të respektojë opinionet e veta të pavarura. Për këtë, nxënësi duhet të aftësohet të tregojë diferencat e mendimeve filozofike, të shpjegojë arsyet se pse njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme, të bëjë lidhjen e pikëpamjeve të ndryshme me interesat e ndryshme ekonomike, politike, fetare etj., si dhe të formulojë pikëpamjen e tij/saj dhe të argumentojë se pse të tjerët duhet ta pranojnë mendimin e tij/saj filozofik.

Në lidhje me respektimin e diversitetit, nxënësi duhet të jetë në gjendje të dallojë vlerat, mendimet dhe pikëpamjet pozitive, të cilat ai/ajo i kundërshton; të argumentojë se çfarëdolloj opinionin, duke përfshirë edhe opinionin e tij/saj, kufizohet nga koha dhe vendi, interesat, arsimi, përfshirja ekonomike, sociale etj.; të jetë në gjendje të tregojë se pse të tjerët duhet ta pranojnë opinionin e tij/saj filozofik, si dhe ta pranojnë opinionin e tij/saj dhe atë të tjetrit si opinion plotësues të diskutimit të përgjithshëm.

Lënda e *Sociologjisë* është lëndë me zgjedhje, që zhvillohet në klasën XII, ajo ka qenë pjesë e kurrikulës bërthamë e arsimit të mesëm për njëzet vjet. Lënda përmban tema mësimore mbi edukimin kulturor dhe ndërkulturor, me përparësi edukimin për qytetari demokratike në bazë të koncepteve të vlerës kulturore, normave kulturore dhe ligjore, simboleve kulturore, gjuhëve, individëve, shoqërisë dhe shoqërisë tradicionale, nënkulturave, relativitetit kulturor, etnocentrizmit, asimilimit, disimilimit, etnicitetit, edukimit ndërkulturor dhe mirëkuptimit ndërkulturor.

Nga pikëpamja sociologjike, lënda përfshin edhe konceptin e besimit fetar dhe të çështjeve të tjera të lidhura me të, të cilat janë të rëndësishme për adresimin e çështjeve të bashkëjetesës paqësore në një botë të larmishme. Ajo bazohet në konceptet e kuptimit sociologjik të fesë, të funksioneve kryesore të saj, harmonisë ndërjetare, si vlerë e veçantë kulturore e shqiptarëve, në llojet kryesore të organizatave fetare, veçoritë kryesore të feve në botë (krishterimi, islamizmi, judaizmi, hinduizmi, budizmi, konfucianizmi), prirjet kryesore të ndryshimit të besimeve fetare në shoqëritë moderne dhe në shoqërinë shqiptare dhe keqinterpretimet dhe keqpërdorimet kryesore të besimeve fetare.

Siç edhe është deklaruar disa vite më parë nga Kryeministri, edukimi ndërkulturor dhe ndërfetar është çështje me përparësi të lartë dhe e tillë është edhe për Këshillin e Evropës. Përveç kësaj, "ndërgjegjësimi dhe shprehja kulturore" është një nga kompetencat kyçe të parashikuara si të këtu në ligjin për arsimin parauniversitar. Të gjithë nxënësit duhet të kenë këtë kompetencë, ndaj edhe rekomandohet përfshirja e kësaj lënde në kurrikulën bërthamë.

Duke pasur parasysh çfarë kemi shënuar më lart, theksojmë se kurrikula e lëndëve të Qytetarisë, Sociologjisë dhe Filozofisë është në përputhje dhe në harmoni me konceptet, praktikat dhe pritshmëritë e KiE-së për edukimin për qytetarinë demokratike dhe për edukimin për të drejtat e njeriut. Pavarësisht kësaj, faktori që ndikon në kurrikulën e lëndëve, që trajtojnë edukimin qytetar, mbetet dinamika e jetës shoqërore dhe politike, e cila e pasuron fushën në fjalë me koncepte të reja. Ndryshe nga fusha e shkencave natyrore, zhvillimet e të cilave janë më të ngadalta, ndryshimet shoqërore dhe politike ndikojnë në lëndët me natyrë shoqërore brenda një kohe të shkurtër. Kështu, sistemi arsimor, shkollat dhe mësuesit përballen me sfidat e ndryshimeve në shoqëri, për të cilat nevojitet një sistem arsimor fleksibël dhe krijues. Ndonëse teorikisht legjislativi është i pakufizuar, praktikisht ky proces nuk është edhe aq fleksibël. Lënda e Qytetarisë është tepër gjithëpërfshirëse dhe ka nevojë për ndryshime vetëm në çështjet prioritare brenda kurrikulës, në përputhje me situatën. ***Megjithatë, sistemi arsimor duhet të rritë fleksibilitetin e pasurimit të kurrikulës ekzistuese me grupe të reja objektivash mësimorë që lidhen me fusha të reja.***

4.3 ROLI I AKTORËVE TË NDRYSHËM NË EQD-në DHE EDNJ-në

Mësimi efektiv në fushën e edukimit të qytetarisë demokratike dhe edukimit të të drejtave të njeriut përfshin një gamë të gjerë aktorësh ku mund të përmendim politikëbërësit, profesionistët e arsimit, nxënësit, prindërit, institucionet dhe autoritetet arsimore, medien dhe publikun e gjerë.

Lëndët e lidhura me *edukimin për qytetarinë demokratike* dhe me *edukimin për të drejtat e njeriut* dhe, veçanërisht, lënda e Qytetarisë, nuk mund t'i realizojnë objektivat e tyre, nëse aktorë të ndryshëm nuk luajnë rolin e tyre përkatës dhe nuk bashkëpunojnë në mënyrë efektive. Përveç rolit të posaçëm të mësuesve të lëndës, edhe prindërit duhet të luajnë rol vendimtar. Situatat e përditshme të sjelljeve të nxënësve dhe qasja e tyre ndaj familjes, miqve dhe shkollës duhet të komunikohet në mënyrë efektive, por edhe të bëhet pjesë e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Procesi i parashikuar për përzgjedhjen dhe certifikimin e teksteve shkollore përfaqëson praktikën e vërtetë të bashkëpunimit mes aktorëve. Përfshirja e teksteve alternative, të ashtuquajtura "*altertekte*", shënon një reformim me karakter të fortë demokratik, pasi përfshin një proces gjithëpërfshirës analizimi dhe përzgjedhjeje, si dhe angazhon një spektër të gjerë aktorësh për realizimin e tij. Në këtë drejtim, politikëbërësit e nivelit ministror dhe të Këshillit të Ministrave, duhet të miratojnë bazën ligjore për kriteret e përzgjedhjes dhe procedurat e konkurrimit, të cilat duhet të jenë të hapura, me të drejta të barabarta dhe transparente për botuesit vendës dhe ata të huaj.⁴⁵ Specialistët e institucioneve arsimore krijojnë programin, botuesit dhe autorët hartojnë tekstet shkollore dhe mësuesit zgjedhin dhe japin ide mbi cilësinë e këtyre teksteve. Vëmendje e veçantë u kushtohet drejtuesve të shkollave, si dhe rolit dhe përgjegjësisë të tyre.

Mësuesit zgjedhin, shkollë për shkollë, një nga tri tekstet alternative për çdo lëndë ose fushë. Ligji parashikon edhe përgjegjësitë e botuesve, duke rregulluar veçmas marrëdhënien me autorët e teksteve shkollore. Ligji për arsimin parauniversitar, i vitit 2012, përfshinte praninë e prindërve në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore në nivel shkolle, por ndryshimet e bëra në këtë ligj në vitin 2015, mënjantuan përfshirjen e prindërve në këtë proces.

Duke pasur parasysh rolin e aktorëve të ndryshëm në nivele të ndryshme, rekomandohet nxitja e partneritetit dhe bashkëpunimit mes aktorëve, me qëllim maksimizimin e kontributeve të tyre. Përfshirja e nxënësve është e pamjaftueshme dhe duhet të përmirësohet.

Në kuadër të qasjes *Shkolla si një e tërë*, që synon krijimin e një mjedisi të sigurt mësimor, roli i nxënësve po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Në shumë raste, ministrat e arsimit u janë referuar qeverive të nxënësve, si një faktor shumë i rëndësishëm për krijimin e një kulture shkollore demokratike, që mund të ndikojë në qeverisjen shkollore demokratike, si dhe mund të çojë në përmbushje më të mirë të misioneve të shkollave në planin afatgjatë.

45. Neni 47 i ligjit nr. 69/2012 "Për arsimin parashkollor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

“Shkolla si qendër komunitare” është nismë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe përfaqëson në vetvete një qasje të re. Shkolla nuk perceptohet si një ishull i izoluar në një zonë gjeografike të caktuar, por është pjesë e një komuniteti dhe i shërben atij. Po ashtu, komuniteti, kur qeveriset në mënyrë demokratike, krijon një kulturë demokracie të dobishme për politikën dhe për praktikën shkollorë demokratike.

Një shkollë si një “qendër komunitare” perceptohet si vendi ku aktorë të ndryshëm mund të takohen dhe, gjithnjë e më shumë, ta shohin veten si partnerët e vërtetë përgjegjës për sistemin arsimor. Drejtuesit e shkollave kanë rol të veçantë në këtë drejtim, për të promovuar hapjen ndaj njerëzve të komunitetit e ndaj të gjithë aktorëve dhe për të krijuar një kulturë bashkëpunimi dhe besimi mes tyre.

4.4 PRAKTIKAT E MËSIMDHËNIES DHE TË TË NXËNIT

Standardet dhe konceptet e KiE-së⁴⁶ nënkuptojnë se praktikën dhe veprimtarinë e mësimdhënies dhe të të nxënies duhet të zbatojnë dhe promovojnë vlerat dhe parimet demokratike dhe të të drejtave të njeriut. Një elementi thelbësor i edukimit për qytetari demokratike dhe edukimit për të drejtat e njeriut është promovimi i kohezionit social dhe i dialogut ndërkulturor dhe vlerësimi i diversitetit dhe i barazisë, duke përfshirë barazinë gjinore. Për këtë qëllim, është thelbësore të zhvillohen njohuri, aftësi vetjake e shoqërore, dhe mirëkuptim që kontribuojnë në uljen e konflikteve, rritjen e vlerësimit dhe të mirëkuptimit të dallimeve mes besimeve të ndryshme dhe grupeve etnike, krijimin e respektit të ndërsjellë për dinjitetin njerëzor dhe vlerat e përbashkëta, nxitjen e dialogut dhe promovimit të zgjidhjes së problemeve dhe mosmarrëveshjeve pa dhunë.

Rëndësia që i kushtohet *edukimit për qytetarinë demokratike* dhe *edukimit për të drejtat e njeriut* krijon përgjegjësi dhe sfida, që duhen qasur në mënyrë të saktë dhe efektive nga sistemi arsimor dhe nga të gjithë aktorët e përfshirë. Miratimi i metodave të duhura për mësimdhënien dhe nxënien i shërben zhvillimit të aftësive qytetare e kompetencave bazë, si: komunikimi dhe shprehitë, të menduarit kritik, të mësuarit për të mësuar, kompetencave individuale dhe digjitale, si dhe kompetencave për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.

Aktualisht, mësuesit kanë si detyrim të trajnohen tri ditë për çdo vit akademik. Mësuesit mund të zgjedhin nga katalogu i trajnimeve që përfshin, ndër të tjera, modulet për kurrikulën e siguruar nga ASCAP-ja për të gjithë mësuesit, drejtuesit dhe mbikëqyrësit.

Faqja e internetit e ASCAP-it <https://www.ascap.edu.al> shërben si burim informacioni për mësuesit dhe përditësohet vazhdimisht me publikime të reja. Mësuesit e lëndës së qytetarisë kanë një dosje të veçantë në këtë qendër burimore, e cila gjatë viteve të fundit është pasuruar edhe me botimin e Këshillit të Evropës “*Udhërrëfyes për mësimdhënien e botëkuptimeve fetare dhe jofetare në edukimin ndërkulturor*”, me vëllimin e dytë të “*Kuadrin të Referencës së Kompetencave për Kulturë Demokratike*

46. Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në kuadër të Rekomandimit KM/Rek. (2010) të Komitetit të Ministrave.

– *Treguesit*“ dhe me botimin e UNESCO-s, “*Manuali i mësuesit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm*“. Dosja përbëhet nga rreth trembëdhjetë publikime, të cilat janë përgatitur kryesisht nga KiE-ja.

Për sa u përket mësuesve të edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut (EQD/EDNJ), vërejmë se rreth një mijë e pesëqind mësues kanë marrë trajnim në punë, si pjesë e procesit reformues kurrikular, i cili ka ndikuar pozitivisht që mësuesit të shprehin gatishmërinë e tyre ndaj përvetësimit të parimeve të EQD-së dhe të EDNJ-së. Gjithashtu, që nga viti 2015, njëqind e njëzet mësues janë trajnuar si trajnerë për EQD-në dhe EDNJ-në.

4.4.1 Zbatimi i kurrikulës

Vlerësimi i zbatimit të kurrikulës është po aq i rëndësishëm sa edhe vlerësimi, tashmë i realizuar, i përputhshmërisë së kurrikulës me standardet dhe me praktikat e KiE-së.

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe ASCAP-ja kanë nxjerrë dhe miratuar udhëzime e materiale mbështetëse për të garantuar zbatimin e njëtrajtshëm të kurrikulës.

Zbatimi i kurrikulës së EQD-së dhe të EDNJ-së në Shqipëri mbështetet në një numër të madh dokumentesh e politikash të KiE-së dhe nga materiale trajnuese për mësuesit, të përgatitur në kuadër të projekteve të KiE-së. Dokumentet e mëposhtme janë përkthyer dhe botuar në faqen e internetit të ASCAP-së:

- ▶ Karta e EQD-së dhe e EDNJ-së dhe të gjitha variantet e tjera të lidhura me të, që janë praktike për përdoruesit;
- ▶ Udhëzimet për edukimin global;
- ▶ RECDC, vëllimet I, II, III;
- ▶ Tabela – *Manuali për mësimin e botëkuptimeve fetare dhe jofetare në edukimin ndërkulturor*;
- ▶ <https://www.living-democracy.al/> faqja e internetit e KiE-së, e përkthyer në gjuhën shqipe, përbëhet nga gjashtë vëllime me shumë veprimtari praktike, që mund të printohen për të gjithë mësuesit dhe nxënësit e të gjitha klasave.

Megjithatë, zbatimi i kurrikulës pengohet nga disa faktorë. Konkretisht, cilësia e përmbajtjes së teksteve shkollore dhe mënyra se si disa tekste shkollore i pasqyrojnë programet mësimore nuk janë të kënaqshme; tekstet shkollore kanë pyetje që janë të përgjithshme, që nuk nxisin diskutimet dhe të menduarit me natyrë analitike ose kritike dhe nuk janë projektuar në bazë të niveleve, në mënyrë që të shënjestrojnë kategori të ndryshme nxënësish; si dhe parimi i barazisë gjinore është pasqyruar në mënyrë sipërfaqësore dhe ende u referohet roleve tradicionale gjinore.

Gjithashtu, mësuesit kanë nevojë për trajnime të shumta sa i përket kuptimit të përmbajtjes, miratimit të teknikave të duhura të mësimdhënies dhe nxënies, si dhe përmirësimit të metodave efektive të vlerësimit. Zgjerimi i përfshirjes së aktorëve të tjerë, si prindërit dhe drejtuesit e shkollave, mund ta kishte ndihmuar procesin e mësimin përmes projektimit, mbështetjes dhe zbatimit të veprimtarive jashtëkurrikulare, që kontribuojnë ndjeshëm në aftësimin e qëndrueshëm të nxënësve me dije, qëndrime dhe aftësi në bazë të KRKQD-së.

4.4.2 Qasja e mësuesve dhe përgjigjja ndaj EQD-së dhe EDNJ-së

Përgatitja dhe qasja e mësuesve, si dhe metodat e përdorura të mësimdhënies, janë me rëndësi vendimtare në përcjelljen e koncepteve dhe praktikave të EQD-së dhe të EDNJ-së. Si pjesë e reformës kurrikulare, pritet që tashmë mësuesit të përdorin qasje me bazë nxënësin, me qëllim përmirësimin e mësimin në klasa. Megjithatë, shumë mësues në Shqipëri vazhdojnë ende të përdorin qasje tradicionale mësimdhënieje me bazë mësuesin; edhe intervistat me mësuesit kanë treguar zbatim të kufizuar të disa prej aspekteve më novatore të reformës, siç janë vlerësimi formues dhe mësimdhënia e aftësive të shekullit XXI.

Mësuesit që japin lëndët e lidhura me EQD-në dhe EDNJ-në duhet ta kapërcejnë programin e lëndës dhe të zbatojnë të nxëniet ndërdisiplinor. Megjithatë, edhe në kuadër të kurrikulës së lëndës, mësuesit duhet t'i hartojnë objektivat e të nxëniet drejt kompetencave, t'i mbështesin nxënësit në zgjedhjen e strategjive të mësimin të përshtatshme për ta, t'i motivojnë nxënësit, të zhvillojnë dhe të projektojnë detyra e projekte që nxisin kreativitetin dhe aftësitë e punës së pavarur, bashkëpunimit, fleksibilitetit, përshtatshmërisë etj. Detyrat dhe projektet duhet të jenë të realizueshme dhe duhet t'i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë sjelljet dhe veprimet e tyre përmes vetëreflektimit.

Programi mësimor i ndihmon mësuesit të planifikojnë zbatimin dhe vlerësimin e veprimtarive arsimore, si dhe arrijtjet e nxënësve brenda dhe jashtë klasës. Megjithatë, ata kanë lirinë e përshtatjes së teknikave të të nxëniet kontekstual, për të cilën nevojitet mbështetja e mësuesve të tjerë të shkollës, e drejtuesve të shkollës dhe e prindërve. Në të vërtetë, liria e mësuesve në këtë drejtim shpesh kundërshtohet nga inspektorët e arsimit, që kërkojnë përputhshmërinë me temat e teksteve shkollore më shumë sesa me objektivat e mësimin të programeve mësimore.

Në realitet, mësuesit e lëndës së Qytetarisë në arsimin fillor dhe, veçanërisht, ato të arsimit bazë, nuk janë diplomuar në këtë fushë dijeje dhe mësimdhënieje. Në përgjithësi, mësuesit që japin lëndën e Qytetarisë nga klasa VI–VII janë kryesisht mësues të historisë dhe gjeografisë, por, në disa raste, edhe mësuesit e lëndëve të tjera e japin lëndën e Qytetarisë për të përmbushur kriterin e ngarkesës mësimore të punës.

Mungesa e dijeve dhe e aftësive të mësuesve në fushat e kurrikulës lëndore, si në ato politike, ligjore, ekonomike, kulturore dhe fetare, ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxëniet të lëndës së EQD-së/EDNJ-së në shkollë. Faktorët e tjerë që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxëniet të lëndëve, që lidhen me EQD-në/EDNJ-në në shkollë, lidhen me natyrën dinamike të jetës sociale dhe politike, zhvlerësimin e shpejtë të informacionit dhe vënien në dyshim të vlerës së mësimave të përditshme për të ardhmen. Për këtë nevojiten mësues reagues dhe fleksibël, të cilët janë në gjendje të ballafaqohen me ndryshimet e shoqërisë. Trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve në fushat e EQD-së/EDNJ-së dhe, në veçanti, në fushën e edukimit për fenë, edukimin ligjor, edukimin kundër ekstremizmit etj., është një mënyrë e frytshme për t'i adresuar këto sfida. Në disa raste, autorët e teksteve shkollore të lëndës së Qytetarisë hartojnë njëkohësisht edhe tekste shkollore për mësuesit, me qëllim që t'i ndihmojnë ata në realizimin e objektivave të mësimin dhe në mbushjen e disa boshllëqeve sa u përket dijeve dhe praktikave të mësuesve për këtë fushë. ***Për lëndën e Qytetarisë, nevojitet përgatitja e materialeve mbështetëse për mësimdhënien.***

Trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve të lëndëve të EQD-së/EDNJ-së, me qëllim aftësimin e tyre me teknika nxënies dhe mësimdhënies të bazuara në kompetenca krijon, gjithashtu, mundësinë e promovimit të një kulture të nxëni jetëgjatë për EQD-në/EDNJ-në dhe promovon modelet e qëndrueshme të të menduarit dhe të vepruarit, si pjesë e skemës konjitive të nxënësit. Gjithashtu, është i nevojshëm edhe trajnimi i mësuesve të lëndës së Qytetarisë lidhur me vlerësimin e nxënësit, si një faktor i rëndësishëm për realizimin e programit të kësaj lënde. Edhe rëndësia që mësuesit i kanë dhënë nuk është e kënaqshme, sidomos mësuesit e klasave I deri V, që zhvillojnë të gjitha lëndët. Mësuesit e arsimit fillor pranojnë se ndonjëherë i kapërcejnë orët që i kushtohen lëndës së Qytetarisë për të mbushur mangësitë e nxënësve në lëndë të tjera, si Matematika apo Gjuha shqipe. ***Gjatë mësimit online, për shkak të pandemisë së COVID-19, lëndët e Qytetarisë, Sociologjisë dhe Filozofisë janë planifikuar dhe përfshirë në diskutime të rregullta online vetëm në disa raste të rralla.*** Mbylljet e shkollave, për shkak të COVID-19, kanë qenë të papritura. Organizimit i trajnimeve të duhura për mësuesit në lidhje me mënyrën se si të garantohet vijueshmëria e mësimit ose si të zhvillohen paketa të përshtatshme mësimore me cilësi të lartë, që të realizohen në distancë, i është kushtuar shumë pak vëmendje. Dhe për më tepër, kjo mund të ketë penguar edhe motivimin e mësuesve, veçanërisht të atyre me aftësi të dobëta në teknologjinë digjitale, pasi iu është dashur të përshtaten me platforma të reja mësimi, si dhe të zhvillojnë strategji të reja për angazhimin e fëmijëve teksa mbajnë dhe ruajnë standardet e larta të mësimdhënies dhe të të nxënësit.

Mësimi *online* është organizuar çdo ditë, por me orar të shkurtuar dhe përmes platformave *online* falas, të cilat kanë kohëzgjatje të kufizuara. Në sesionet *online* dhe në detyrat që u janë dhënë nxënësve, koha e disponueshme i është kushtuar lëndëve, që konsiderohen si më të rëndësishme, si lëndët shkencore dhe ato gjuhësore, e shumë pak vëmendje i është kushtuar lëndës së Qytetarisë.

Vlerësimi i nevojave dhe trajnimi i mësuesve të lëndës së Qytetarisë përbëjnë çështje me përparësi të lartë, në mënyrë që të identifikohen ndërhyrjet që adresojnë përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësit, por edhe që sjellin rezultate pozitive në situatën aktuale të edukimit për qytetari demokratike në shkolla. Gjashtë manualët e KIE-së “Demokracia në veprim”, të cilat janë testuar nga arsimtarët dhe kanë rezultuar mjaftueshëm fleksibël për të trajnuar mësuesit që të përfshijnë në klasat e tyre edukimin për qytetari dhe për të drejtat e njeriut në mënyrë ndërvepruese, argëtuese, por edhe sfiduese, mund të shërbejnë si bazë e mirë për zhvillimin e kurrikulës së trajnimit dhe për trajnimin e trajnerëve.

Trajnimi i mësuesve është çështje me përparësi të lartë. ASCAP-ja është përgjegjëse për zhvillimin e programeve trajnuese për mësuesit, që bazohen në standardet e trajnimit të mësuesve. Kurrikula ekzistuese, që bazohet te KRKKD-ja, kërkon standarde të reja për trajnimin e mësuesve. Duke qenë se ASCAP-ja është përgjegjëse për kurrikulën e trajnimit të mësuesve, analizimi i standardeve të saj është çështje me përparësi për të. Mësuesit do të trajnohen për përdorimin e platformës së vetëreflektimit, që do të përdoret në procesin e vlerësimit, platformë e cila aktualisht është në proces pilotimi⁴⁷.

47. <https://www.coe.int/en/web/reference-framework-of-competences-for-democratic-culture/-reflection-tool-for-teachers>

Dokumenti i vlerësimit⁴⁸ rekomandon rritjen e mbështetjes për mësuesit në zbatimin e kurrikulës së re me bazë kompetencat. **Mbështetja duhet të jepet për trajnimet, infrastrukturën e anën institucionale** dhe është e lidhur me nivelin e financimit të sistemit arsimor në Shqipëri, i cili është aktualisht në nivele të pakënaqshme. Shpenzimet për arsimin, gjatë viteve të fundit, kanë mbetur në vlerën e 3,2% të PBB-së, ndërkohë që mesatarja në vendet e OECD-së është rreth 5%⁴⁹.

Në përgjithësi, që EQD-ja/EDNJ-ja të ketë sukses, është jashtëzakonisht e rëndësishme që mësuesit, drejtuesit dhe aktorët e tjerë të arsimit të mbajnë një qëndrim pozitiv drejt qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut. Edhe nëse EQD-ja/EDNJ-ja garantohet nga strategjitë dhe dokumentet e tjera arsimore, ato nuk do të kenë sukses pa mbështetjen e fuqishme të profesionistëve të tyre. Të qenët “mësues demokratik” kërkon më shumë sesa thjesht të jesh i përgatitur në një lëndë të caktuar. Për këtë, nevojitet, ndër të tjera, aftësia për të dëgjuar nxënësit, kolegët dhe prindërit, vlerësimi i diversitetit kulturor dhe ndjenja e përgjegjësisë për mirëqenien dhe fuqizimin e të gjithë nxënësve. Ndërkohë nevojitet një ndryshim në sjellje dhe qëndrim dhe kjo duhet kuptuar si një proces i vazhdueshëm.

4.4.3 Tekstet shkollore

Në përputhje me ligjin për arsimin parauniversitar, tekstet shkollore janë pjesë e kurrikulës së shkruar dhe të zbatuar. Teksti shkollor është mjeti i procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit, që zhvillohet në kuadër të zbatimit të programit mësimor të lëndës.

Në përputhje me ligjin, tekstet shkollore janë pjesë e kurrikulës, ndaj duhet të garantohet se ato ofrojnë të gjitha mundësitë, që:

- ▶ nxënësit të ndërtojnë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësitë e qëndrimet e shprehura në kurrikul, në mënyrë që të jenë të aftë:
 - ▶ të kuptojnë, të analizojnë dhe të trajtojnë në mënyrë kritike politikat sociale dhe mënyrat të cilat ato zbatohen;
 - ▶ të zhvillojnë aftësi për pjesëmarrje qytetare dhe përfshirje të ndërgjegjshme e cilësore në zgjidhjen e problemeve komunitare;
 - ▶ të zhvillojnë angazhimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të nevojshme për bashkëjetesën në një shoqëri demokratike;
 - ▶ të gjykojnë në mënyrë kritike shkallën e funksionimit të demokracisë në shoqërinë shqiptare;
- ▶ mësuesit të organizojnë një proces mësimdhënieje dhe nxënieje të bazuar në kompetenca.

Në këtë drejtim, lind nevoja e identifikimit dhe hartimit të një liste autorësh të kualifikuar teksteve shkollore, të cilët gjithashtu kanë nevojë për trajnim. Sa u përket autorëve të teksteve shkollore, rekomandohet bashkimi i tyre në ekip me mësuesit

48. Vlerësim i Strategjisë për Arsimin Parauniversitar 2014–2020, Raporti Final, MAS, mbështetur nga UNICEF-i Shqipëri.

49. UNICEF – Arsimi në Shqipëri 2020, faqja e internetit <https://www.unicef.org/albania/education>, aksesuar më 20.8.2020.

dhe psikologët, në mënyrë që të garantohet përputhshmëria e përmbajtjes së teksteve shkollore me nivelin e kuptimit dhe të zhvillimit të nxënësve.

Shtëpitë botuese dhe autorët e teksteve shkollore duhet të kuptojnë mirë kërkesat e përgjithshme të programeve mësimore dhe, pas kësaj, të krijojnë një instrument pedagogjik që do t'u shërbejë mësuesve në organizimin e procesit të të nxënësve. Tekstet shkollore shërbejnë, gjithashtu, që nxënësit të kenë mundësi të fitojnë dijet dhe aftësitë e kërkuara nga kurrikula. Procesi i parashikuar për përzgjedhjen dhe certifikimin e teksteve shkollore është shembulli i identifikuar i një bashkëpunimi të mirë mes aktorëve.

Kriteret dhe objektivat e teksteve shkollore

Në përputhje me kërkesat e përcaktuara për shtëpitë botuese, lidhur me cilësinë e teksteve shkollore, tekstet e lëndës së Qytetarisë, duhet:

- ▶ të aftësojnë nxënësit për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale të nevojshme për të kuptuar, analizuar dhe ndikuar në politikat sociale dhe në mënyrat e zbatimit të tyre;
- ▶ të zhvillojnë aftësitë e nxënësve për pjesëmarrje qytetare dhe përfshirje të ndërgjegjshme e cilësore në zgjidhjen e problemeve komunitare;
- ▶ të zhvillojnë angazhimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të nevojshme për bashkëjetesën në një shoqëri demokratike;
- ▶ të aftësojnë nxënësit që të përcaktojnë kriteret dhe të gjykojnë në mënyrë kritike shkallën e funksionimit të demokracisë në shoqërinë shqiptare;
- ▶ të krijojnë kulturën demokratike të të menduarit dhe të të vepruarit, si dhe të përdorin modelet respektive.

Në bazë të standardeve për tekstet shkollore⁵⁰, procesi i vlerësimit bazohet në katër shtylla:

- ▶ përputhshmëria kurrikulare, formatimi dhe prezantimi, të cilat vlerësohen në bazë të standardeve 1 deri në 3;
- ▶ çështjet shkencore dhe didaktike të adresuara në bazë të standardeve 4 deri në 8;
- ▶ çështjet pedagogjike të vlerësuara në bazë të standardeve 9 deri në 12;
- ▶ çështjet që lidhen me praktikën pedagogjike, të cilat vlerësohen në bazë të standardeve 13 deri në 15.

Programi mësimor ka karakter si detyrues ashtu edhe rekomandues. Ndonëse tekstet duhet të jenë në përputhje me programin mësimor, kjo nuk do të thotë se ato janë një pasqyrim i thjeshtë i tij. Nga ana tjetër, tekstet mund të përfitojnë nga hapësirat dhe fleksibiliteti i programit mësimor, si dhe nga disponueshmëria e orëve apo përsëritjet e tyre, në mënyrë që të rrisin vlerat dhe mundësitë e përmbushjes së qëllimeve të shprehura ose të nënkuptuara. Pedagogjia e përdorur për zhvillimin e njësive të mësimdhënies ka ndikim vendimtar në kufizimin ose shtimin e mundësive të përvetësimit të objektivave të lëndës. Prandaj, ajo duhet përdorur në mënyrë efektive dhe profesionale për përmbushjen e kompetencave të synuara.

50. Urdhri i ministrit të Arsimit nr. 155, datë 22.4.2015, i ndryshuar me urdhrin e ministrit të Arsimit nr. 640, datë 13.12.2017, "Për miratimin e standardeve për librat shkollorë".

Tekstet shkollore të lëndës së Qytetarisë duhet të sjellin në klasë realitetin shqiptar, mjedisin dhe mikromjediset, si dhe atë çfarë shihet e dihet e atë që është e padukshme. Aspektet e paqarta apo të panjohura të situatave të ndryshme duhet të zbulohen, të studiohen e kuptohen ose ndryshohen. Tekstet shkollore të EQD-së duhet të jenë të paanshme dhe të mos përmbajnë paragjykime. Ato duhet të krijojnë klimë të përshtatshme për respektimin e pikëpamjeve të ndryshme të nxënësve dhe mësuesve.

Për nga pikëpamja pedagogjike, tekstet shkollore të EQD-së duhet të bëjnë të mundur realizimin e objektivave të të nxënësve dhe të elementeve të tij, si: të kuptuarit, njohuritë, aftësitë, qëndrimet, vlerat dhe prirjet. Tekstet shkollore duhet të ofrojnë situata mësimi, që mundësojnë realizimin e objektivave të mësipërm, si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit.

Detyrat dhe pyetjet – rëndësia e tyre

Përveç përmbajtjes, detyrat dhe pyetjet që hartohen në fund të çdo mësimi në tekstet shkollore që trajtojnë EQD-në janë, gjithashtu, shumë të rëndësishme për nga pikëpamja e objektivave të mësimi, si dhe në lidhje me qëllimet e kësaj analize. Pyetjet duhet të testojnë aftësitë kuptuese të nxënësit dhe ta ndihmojnë atë që ta asimilojë informacionin e tekstit në mënyrë të pavarur. Përmes pyetjeve udhëzohemi si të dallojmë atë çka është më thelbësore nga ajo çka është më pak e tillë. Përmes detyrave, nxënësit përfshihen në projekte të vogla, që pasqyrojnë dhe përmirësojnë të nxënësve mbi lëndën dhe, ndonjëherë, për realizimin e këtyre detyrave përfshihet një ekip i tërë pune ose kërkohet përfshirja e prindërve.

Në varësi të objektivave të lëndës dhe të objektivave të programit, nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari që synojnë zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ, të analizës dhe sintezës së një situatave të dhënë. Pyetjet dhe detyrat krijojnë situata dhe diskutime në të cilat nxënësit duhet të krijojnë opinionet dhe qëndrimet e tyre të pavarura, duhet t'i mbështesin ato me argumente, si edhe të dallojnë, të pranojnë, të respektojnë dhe të marrin në konsideratë argumentet e të tjerëve.

Pyetjeve dhe detyrave duhet t'u kushtohet më shumë rëndësi. Rekomandohet që ato të jepen si detyrë shtëpie ose si detyrë në klasë, me qëllim që nxënësit të angazhohen në veprimtari të pavarura kërkimore, mbledhjen e informacionit, nxjerrjen e përfundimeve të bazuara në fakte dhe në interpretimin e mendimit të tyre, të bazuar në përfundimet e nxjerra. Ato nxënësit të menduarin analitik dhe kritik, sapo nxënësi të zbulojë lidhjet e zakonshme të dukurive sociale ose të fakteve dhe situatave të tjera interesante.

Gjendja e teksteve shkollore në Shqipëri

Në Shqipëri, tekstet shkollore janë burimi kryesor i procesit të mësimi në shkollë dhe në mjedise të tjera mësimore. Rëndësia e teksteve shkollore do të vazhdojë të mbetet e tillë në lidhje me burimet e tjera të të mësuarit, për shkak të pabarazisë së mundësive që ekzistojnë ndërmjet rajoneve, shkollave, familjeve të ndryshme, si dhe të nivelit të mësuesve e të nxënësve.

Rekomandohet, që në një periudhë të shkurtër kohore, tekstet të jenë burimi kryesor i procesit mësimor, sepse cilësia e mësuesve, veçanërisht, e atyre që japin lëndën e Qytetarisë, është e ndryshme, gjë që nuk garanton të njëjtën cilësi mësimdhënieje dhe nxënieje për të gjithë nxënësit. Për këtë qëllim, cilësia e teksteve shkollore mbetet

parësore. Kjo duhet të shkojë paralelisht me trajnimin e mësuesve për metodologjitë me në qendër nxënësit, me mësimdhënien dhe të nxënëit aktiv. Mësuesit duhet ta nxisin më shumë punën në grup, pra punën me projektet, por edhe veprimtaritë jashtë kurrikulës që t'u krijojnë nxënësve mundësi për ta kontekstualizuar informacionin, njohuritë, vlerat dhe qëndrimet e marra, si individë dhe si pjesë e komunitetit.

E ashtuquajtura reforma e *"alterteksit"*, që përbëhet nga tekste shkollore alternative, ka ndikuar përgjithësisht në cilësinë e këtyre teksteve, si edhe në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënëit. ***Pjesëmarrja e një game të gjerë aktorësh në proces ka rritur konkurrencën dhe përgjegjësinë e botuesve për ta pajisur tregun me libra të cilësisë së lartë. Gjithashtu, kjo ka ndikuar që mësuesit të bëhen më të vetëdijshëm për programin dhe të rishikojnë me kujdes tekstet, pasi atyre iu është dhënë liria për të zgjedhur tekstet shkollore, që, sipas tyre, janë më të mirat për nivelet e nxënësve të tyre.*** Botuesit dhe autorët e teksteve shkollore konkurrojnë në bazë të rregulloreve të zhvilluara dhe të miratuara nga MAS-i.

Kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e teksteve shkollore vlerësojnë kryesisht nëse teksti siguron zbatimin e kurrikulës dhe nëse përmbush standardet e miratuara. Procedura e konkursit të teksteve kërkon miratim dhe certifikim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për jo më shumë se tri tekste shkollore gjatë vitit dhe për çdo lëndë mësimore/kurrikul. Certifikimi evidentohet përmes vulës me hologramë në çdo kopje të tekstit shkollor, e cila konfirmon procedurën e certifikimit nga ministria. Ministri miraton edhe çmimin e shitjes së teksteve shkollore.⁵¹

Ndonëse mësuesit, autorët e teksteve shkollore dhe nëpunësit publikë të intervistuar vlerësojnë mundësinë e ofrimit të teksteve alternative për të njëjtën lëndë, ka të tjerë që e kundërshtojnë atë.⁵² Meqenëse programi mësimor i lëndës përmban rezultate mësimore të nxënësve, si dhe sugjerime për përmbajtjen dhe konceptet kyçe, ofron edhe mundësinë e të kuptuarit në mënyra të ndryshme nga përdorues/autorë të ndryshëm. ***Pra, tekstet shkollore alternative kanë, edhe teorikisht, mundësinë e përputhshmërisë me kërkesat e programeve mësimore të lëndëve në mënyra të ndryshme. Rrjedhimisht, kjo prek parimin e mundësive të barabarta për nxënësit, për sa i përket përfuturit të dijeve dhe aftësive.***

Mësuesit, autorët e teksteve shkollore dhe nëpunësit publikë të intervistuar, që i kundërshtojnë tekstet alternative, theksojnë se rreziku i ***mundësive të pabarabarta për nxënësit rritet, në rastet kur autorët e teksteve nuk janë specialistë të fushës. Sipas opinionit të tyre, mundësia e teksteve alternative në disa raste ka treguar përfshirje të autorëve amatorë dhe joprofionistë*** ose të autorëve me nivele shumë të larta e përvojë shumë të madhe profesionale, por të papërshtatshme me lëndën e Qytetarisë.

Autorët e teksteve shkollore, në disa raste, krijojnë njësi mësimore që nuk mundësojnë plotësisht rezultatet e pritura të programit mësimor për atë njësi mësimore. Në veçanti, këto njësi nuk krijojnë mundësinë e organizimit të situatave mësimore, në mënyrë të tillë që përmes kompetencave, si aftësia e përdorimit të dijeve dhe aftësive, të zgjidhin një problem të caktuar.

51. VKM-ja nr. 107, datë 10.2.2010 "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar".

52. Vlerësimet e mbledhura nga intervistat me mësuesit, autorët e teksteve dhe nëpunësit publikë.

Në disa raste, autorët e teksteve shkollore të lëndës së Qytetarisë nuk i kuptojnë aq sa duhet njohuritë e fushave që janë pjesë e kësaj lënde, si p.sh. kontekstet politike, ekonomike, sociale, ligjore ose kulturore. Prandaj, ato mund ta shpërfillin vlerën e dijeve, të ideve dhe të koncepteve të lidhura me njohuritë e këtyre fushave. Rreziku i moskryerjes së detyrës në mënyrën e duhur rritet kur mësuesi i lëndës së EQD-së nuk është profesionist i fushës, por është mësues i arsimit fillor ose mësues i Gjeografisë apo i Historisë, të cilit i është besuar kjo lëndë, me qëllim që të përmbushë ngarkesën mësimore. Analizimi i teksteve shkollore identifikoi si gjetje dytësore faktin se pjesa më e madhe e autorëve të lëndës së Qytetarisë janë femra.

Informacioni i mbledhur nga intervistat dhe pyetësorët e kryer me mësuesit ose me prindërit, tregon se tekstet shkollore të lëndës së Qytetarisë, nga njëra anë, kanë koncepte që janë të vështira për grup-mosha të caktuara dhe, nga ana tjetër, konceptet, që gjenden në to, nuk shpjegohen qartë ose mbeten të pashpjeguara. Në të dyja rastet, ***nxënësit ndeshen me vështirësinë e marrjes së informacionit dhe të kuptimit të koncepteve***. Vështirësitë dallohen edhe kur teksti përmban informacione të papërshtatshme për moshën e nxënësit, veçanërisht kur autorit i mungon përvoja e të punuarit me fëmijët ose informacioni i dhënë nuk kërkohet nga programi mësimor.

Në disa raste, edhe pse materiali i mësimdhënies bazohet në një sasi të caktuar informacioni, mënyra e organizimit të lëndës nuk mundëson procesin e krijimit të njohurive. Në raste të tjera, nxënësi largohet nga klasa thjesht me idenë e pjesëmarrjes në një proces diskutimi, por pa marrë dijet e nevojshme dhe aftësitë e duhura për lëndën.

Shpesh, në tekstet shkollore të arsimit fillor, veçanërisht në lëndët e Qytetarisë dhe të Historisë, së klasës së katërt, ka mbivendosje të temave, si për shembull, kur shpjegohet familja, kultura, traditat dhe zakonet, të cilat përfshihen në të dyja lëndët dhe ndonjëherë në mënyrë jo të unifikuar, si në rastin e shpjegimit të konceptit të familjes patriarkale. ***Rekomandohet që njëri prej teksteve të përmbajë të gjithë informacionin dhe temat në fjalë të hiqen nga teksti tjetër ose të dyja tekstet të japin informacione plotësuese të njëra-tjetrës. Zakonisht, temat e zakonshme shërbejnë për integrimin ndërdisiplinor, por vetëm atëherë kur programi dhe objektivat janë të ndryshëm, gjë që nuk duket se është ky rast.***

Udhëzuesi për kurrikulën⁵³ këshillon përdorimin e burimeve alternative mësimore, në rastet kur mësuesit vërejnë mungesa të njohurive, koncepteve dhe temave të përcaktuara nga programi mësimor në një tekst të përzgjedhur ose kur ky tekst nuk përmbush rezultatet e mësimin. Por, ***liria e mësuesve në eksplorimin e burimeve alternative mësimore duhet të mbështetet nga trajnimet e mësuesve për përmbushjen e këtij qëllimi.***

Dokumenti i vlerësimit të strategjisë për arsimin parauniversitar tregon se ecuria e përzgjedhjes dhe sigurimit të teksteve shkollore ka qenë e mirë. Megjithatë, strategjia rekomandon që MAS-i të shqyrtojë politikën e botimeve dhe të punojë me botues vendorë, për të prodhuar tekste shkollore në përputhje me kornizën kurrikulare, duke pasur parasysh kontekstualizimin e atyre teksteve shkollore të prodhuara nga botues të huaj.

53. Udhëzuesi për kurrikulën, IZHA, 2018.

Pasqyrimi i parimeve të barazisë gjinore në tekstet shkollore të Qytetarisë

Respektimi i parimeve të barazisë gjinore ka qenë në qendër të vëmendjes së disa dokumenteve ligjore dhe politikave në fushën e arsimit. Në këtë aspekt, strategjia për arsimin parauniversitar dhe standardet e teksteve shkollore, synojnë të promovojnë parimet e barazisë gjinore dhe të reduktojnë sa më shumë që të jetë e mundur stereotipat gjinorë. Standardi i 11-të⁵⁴, për vlerësimin e teksteve shkollore, lidhet me pasqyrimin e barazisë gjinore në tekst. Një nga kushtet që teksti të kualifikohet midis tri teksteve alternative, lidhet me përmbushjen e këtij standardi.

Me sa duket, respektimi i standardeve të barazisë gjinore është pasqyruar në mënyrë sipërfaqësore nga autorët. Analizimi i teksteve shkollore tregon vëmendjen dhe kujdesin e autorëve përkundrejt barazisë gjinore. Në ilustrimet me fotografi, paraqitja artistike e personazheve është e drejtë dhe ka raport pothuajse të barabartë mes femrës dhe mashkullit. Gjithashtu, nëse do të numëronim personazhet meshkuj dhe femra, do të vihej re se përdorimi i emrave mashkullorë dhe femërorë është ruajtur në një raport të barabartë.

Ndonëse autorët janë treguar të kujdesshëm në ruajtjen e roleve gjinore, sa u përket numrave dhe ilustrimeve, ata nuk kanë arritur t'i shmangin me sukses stereotipat gjinorë. Në tekstet shkollore, mësuesi është gjithmonë femër, trajneri i fëmijëve është figurë mashkullore, polici dhe veterineri janë po ashtu meshkuj; edhe sa u përket zgjidhjeve të problemeve, gjithmonë është një mashkull që gjen zgjidhjen e problemit ose ndihmon në gjetjen e tij. Zjarrfikësit dhe marangozët janë gjithmonë meshkuj, pasi në kulturën shqiptare këto profesione nuk janë praktikuar kurrë nga femrat. Rrobaqepëset, në ilustrime, janë gjithmonë femra, ndonëse tradicionalisht ne kemi pasur rrobaqepës meshkuj. Në bazë të stereotipave të vazhdueshëm, femrat shfaqen ende në rol, kryesisht, të brishta, duke u kujdesur për të vegjlit, duke bërë punët e shtëpisë, duke u shërbyer të tjerëve ose duke bërë dhurata. Nga ana tjetër, karakteri i djemve shpesh rezulton i gabuar ose me sjellje të keqe dhe gjendet vajza që me karakterin e saj i tregojnë atij sjelljen e duhur.

Intervistat me mësuesit zbuluan një dukuri, që ndodh në ditët e sotme në shkollë. Fëmijët luajnë lojëra vajzash, që janë të ndryshme nga lojërat e djemve, ndarje që praktikohet në klasat e edukimit fizik, ku, në shumicën e rasteve, nxënësit ushtrohen të ndarë. ***Situata të tilla, që u referohen lojërave për djem dhe për vajza, janë pasqyruar gjithashtu dhe në tekstet shkollore të lëndës së Qytetarisë.***

Ndonjëherë, në përpjekje për të shmangur stereotipat, autorët përfshijnë ndodhi ose situata që nuk përputhen me realitetin tonë. Kështu, tekstet në raste që përshkruajnë situata tipike shqiptare, përdorin foto ilustruese me personazhe të racave të ndryshme që nuk përshtaten me realitetin tonë. ***Megjithatë, sjellja e shembujve të situatave të pazakonta për realitetin tonë, mund të shërbejë për hapjen e perspektivave të reja të informacionit dhe të të menduarit.***

Përveç historive dhe figurave, semantika e gjuhës ka edhe shembuj të tjerë, si p.sh.: mbizotërimi i përgjithësimin mashkullor me “ai” ose “atij”. Gjithashtu, në tekstet shkollore të *Gjuhës shqipe*, profesionet emërohen në gjininë mashkullore.

54. Urdhri i ministrit të Arsimit nr. 155, datë 22.4.2015, i ndryshuar me urdhrin e ministrit të Arsimit nr. 640, datë 13.12.2017, “Për miratimin e standardeve për librat shkollorë”.

Roli i mësuesve në garantimin e barazisë gjinore

Mësuesit kanë ende rolin më të madh në edukimin dhe socializimin e fëmijëve dhe në promovimin e barazisë gjinore. Që në ditën e parë të shkollës, mjedisi shkollor, mësuesit dhe shokët e shoqet e klasës, tekstet shkollore dhe lojërat në shkollë ndikojnë në personalitetin, sjelljen dhe identitetin e fëmijës. Një rol i tillë i mësuesit e lidh atë ngushtë me prirjet e edukimit të barabartë të nxënësve. **Objektivat e strategjisë nuk do të kishin kuptim, nëse nuk do të ndiqeshin në mënyrë të përgjegjshme nga mësues të përkushtuar dhe të motivuar, të cilët e kuptojnë mirë rëndësinë e madhe psikologjike dhe sociale të edukimit të fëmijëve, të bazuar në konceptin e barazisë. Ata duhet të reflektojnë mbi këto vlera, duke i zbatuar në praktikat e mësimdhënies e të nxënësve dhe për të ndryshuar qëndrimet vetjake.** Kjo shkon në përputhje me rekomandimin e KiE-së për parandalimin dhe luftimin e seksizmit,⁵⁵ i cili u rekomandon qeverive anëtare që të marrin masa për parandalimin dhe luftimin e seksizmit dhe të manifestimeve të tij në sferat publike dhe private, si dhe të nxisin aktorët përkatës që të zbatojnë legjislacionin, politikat dhe programet përkatëse, duke u mbështetur në përkufizimin dhe udhëzimet që i bashkëngjiten rekomandimit.

Edhe detyrat më të vogla dhe ndarja e tyre e pastandardizuar mes djemve dhe vajzave, si p.sh. pastrimi i klasës, vendosja e vazove dhe organizimi i aktiviteteve sportive me pjesëmarrje të barabartë, mund të sjellë ndryshim. Vlen të theksojmë së sjellja e mësuesve duhet të shkojë drejt promovimit të vlerave të çdo nxënësi dhe jo drejt kuadrove stereotipike të vajzës apo të djalit.

Përfshirja e lëndës “Gjinia dhe zhvillimi” në kurrikulën universitare të programit të studimeve master, shënoi një hap pozitiv në drejtim të trajnimit, por, fatkeqësisht, kjo zgjati vetëm për dy vjet. Programe të tilla janë të domosdoshme, pasi rrisin ndjeshmërinë ndaj çështjes në fjalë, veçanërisht, për mësuesit e ardhshëm, por edhe për punonjësit socialë ose psikologët e shkollave.

Pasqyrimi stereotipik duhet të trajtohet me kujdes e në mënyrë të detajuar, që të ofrojë perspektiva më asnjëse dhe karaktere të barabarta në rolet jotradicionale, por gjithsesi të përshtatshme me kontekstin social. Kujdes dhe vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet autorëve të teksteve dhe mësuesve, të cilët duhet t’i shohin nxënësit sipas parimit të barazisë dhe të angazhohen në mënyrë aktive në promovimin e barazisë gjinore.

Promovimi i barazisë gjinore është përgjegjësi e rëndësishme në të gjitha fushat e edukimit. Përmes këtij parimi ne mund të garantojmë jo vetëm përmbushjen e nevojave bazë të djemve dhe vajzave, por edhe t’u ofrojmë mundësi atyre për të arritur potencialin e tyre të plotë e të përmbushin të drejtat e tyre njerëzore. Përmes kurrikulës, teksteve shkollore dhe proceseve të mësimdhënies dhe të nxënies së baraspeshuar për nga pikëpamja gjinore, djemtë dhe vajzat përftojnë në mënyrë të barabartë aftësitë, vlerat dhe qëndrimet e nevojshme, për të përmbushur potencialin e tyre brenda dhe jashtë sistemit arsimor, pavarësisht gjinisë së tyre. Është koha të angazhohet në të gjitha instrumentet dhe kapacitetet e disponueshme ligjore, institucionale, kurrikulare drejt përqafimit të vizionit të ri të barazisë gjinore. **Ndërtimi i kapaciteteve për mësuesit dhe autorët e teksteve shkollore, që i përgjigjen një mentaliteti vizionar, është dhe duhet të jetë detyra kyçe e sistemit arsimor.**

55. Rekomandimi KM/Rek. (2019)1 për Parandalimin dhe Luftimin e Seksizmit.

Një element tjetër, që duhet përmirësuar, është monitorimi dhe vlerësimi i barazisë gjinore në shkolla nga autoritetet përkatëse, në përputhje me rekomandimin e KiE-së për barazinë gjinore në arsim⁵⁶, i cili sugjeron krijimin e mekanizmave përmes sistemit arsimor, në favor të promovimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të barazisë gjinore në shkolla.

4.4.4 Vlerësimi i arritjeve të nxënësve

Vlerësimi është, gjithashtu, një komponent, i cili mbahet parasysh për analizimin e objektivave të mësimin për EQD-në dhe për EDNJ-në, si dhe për realizimin e kurrikulës së lëndëve përkatëse. Ligji për arsimin parauniversitar⁵⁷ rregullon objektin dhe kriteret e vlerësimeve, të cilat shtjellohen më tej në udhëzuesin përkatës të ministrit të Arsimit, dhe Sportit⁵⁸, si dhe në dokumentin shpjegues të hartuar nga IZHA-ja⁵⁹.

Vlerësimi i nivelit të mësimin të nxënësve bëhet përmes vlerësimit sistematik, vlerësimit me teste/testime përmbledhëse dhe vlerësimit të portofolit të nxënësit. Vlerësimi sistematik bazohet te vëzhgimet dhe te gjykimet e mësuesit mbi përgatitjen e nxënësit, punën në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e tij nga nxënësit e tjerë, pjesëmarrjen në veprimtaritë e klasës e në debate dhe në vlerësimin e detyrave të shtëpisë ose të klasës. Vlerësimi sistematik është, gjithashtu, pjesë e mësimdhënies dhe i motivon nxënësit përmes përfshirjes në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.

Vlerësimi përmes testeve ka për qëllim matjen e nivelit të arritjeve të rezultateve të caktuara të nxënësve, përgjithësisht, për periudha tremujore. Kjo metodë vlerësimi parakupton që ta orientojë mësuesin se në cilat drejtime duhet të përmirësohet procesi i të nxënësve.

Në bazë të natyrës së lëndëve sociale dhe, veçanërisht, të lëndëve përkatëse të EQD-së dhe të EDNJ-së, që synojnë të promovojnë zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të përgjegjshëm, si dhe t'i pajisin ata me dijet, vlerat dhe qëndrimet e qytetarisë demokratike, ***metoda e tretë e vlerësimit, që bazohet në vlerësimin e portofolit të nxënësit, është me rëndësi thelbësore.*** Vlerësimi i nxënësit, që bazohet te portofoli, ka për qëllim monitorimin dhe vlerësimin e nxënësit në një kontekst më të gjerë, duke përfshirë dokumentimin e kontributeve dhe arritjeve të tij/saj në këtë fushë ose lëndë, kompetencat kyçe, punën individuale dhe atë në grup, kreativitetin, talentin dhe aspektet e gjykimin dhe reflektimit të nxënësve mbi veten dhe të tjerët.

Detyrat dhe projektet e vlerësuar me anë të kësaj metode përfshijnë punën individuale dhe atë në grup, si dhe kontributin e prindërve, veçanërisht për fëmijët e klasave të ulëta. Portofoli i nxënësit përmban punët dhe detyrat e pavarura të bëra në klasë, në shtëpi dhe jashtë saj, projektet individuale ose në grup dhe krijimet tematike të shkruara ose ato audiovizuale (sipas talentit) dhe kërkime mbi kreativitetin

56. CM/Rekomandimi Rek. (2007)13 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për barazinë gjinore në arsim.

57. Neni 48 i tij.

58. Udhëzuesi i MAS-it, nr. 34, datë 11.09.2015, "Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca në arsimin bazë".

59. Material shpjegues për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (IZHA, 2018).

e nxënësve. Kjo metodë përfshin vetëvlerësimet e nxënësit dhe reflektimet e prindërit mbi ecurinë e fëmijës.

Përfshirja e nxënësve në projekte ndihmon në përfitim të aftësive, të tilla si: mësimi përmes kërkimeve, aftësitë e pavarura, kërkimi dhe përzgjedhja e burimeve të informacionit, kërkimi i burimeve kryesore, mbledhja e të dhënave, interpretimi i të dhënave, analizimi, sintetizimi, krijimi i bazës së kuptimit mbi një situatë të dhënë, nxjerrja e përfundimeve, marrja dhe mbrojtja e një pozicioni, marrja e një vendimi dhe komunikimi i tij.

Pavarësisht qëllimeve dhe qasjes gjithëpërfshirëse të vlerësimit të nxënësit në bazë të portofolit, mënyra se si mësuesit i projektojnë detyrat që do të vlerësohen përmes kësaj metode, rëndësia e pakët që ata i kanë dhënë kësaj metode në diskutime dhe në prezantimin e punëve të veçanta dhe bashkëpunimi i pamjaftueshëm i prindërve ka ulur vlerën e kësaj metode vlerësimi, si dhe të qëllimit të saj. Në shumë raste, mësuesi kërkon informacion dhe u jep nxënësve detyra në mënyrë të tillë që nuk i motivon ata që të kërkojnë dhe të përdorin talentin e aftësitë e tyre. Në raste të tilla, puna e bërë nga fëmijët është e pavlerë dhe, ndonjëherë, mbetet thjesht një dokument i printuar nga faqet e internetit. ***Edhe vlerësimi i nxënësve përmes kësaj metode është i dobët.*** Nxënësit marrin nota të larta, nëse e përmbushin detyrën e tyre dhe notë të ulët, nëse nuk e paraqesin atë. ***Cilësia e detyrës nuk përbën ndonjë ndryshim në vlerësim.***

4.4.5 Provimi i maturës

Lënda e Qytetarisë është lëndë me zgjedhje edhe në provimet e maturës. Për të gjitha provimet e maturës, ASCAP-ja harton një program udhëzues për nxënësit dhe për mësuesit. Nga programi i udhëzuesit për Qytetarinë, që përfshin dhe lëndën e Sociologjisë e të Filozofisë, nxënësit dhe mësuesit marrin informacionet e duhura rreth asaj çka pritet prej tyre, sa u përket tri niveleve të performancës. Këto nivele merren parasysh nga agjencia përgjegjëse për maturën në procesin e hartimit të pyetjeve dhe në përcaktimin e peshës së çdo niveli në test, si më poshtë:

- ▶ ***niveli i ulët*** – aftësia për të identifikuar dhe përshkruar etj. → 40% e vlerësimit;
- ▶ ***niveli mesatar*** – aftësia për të shpjeguar dhe analizuar lidhjen shkak-pasojë → 40%;
- ▶ ***niveli i lartë*** – aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim → 20%.

Lënda e Qytetarisë është zgjedhur nga një numër i lartë nxënësish, por jo për ndonjë arsye domethënëse. Disa nxënës e zgjedhin këtë lëndë, pasi e konsiderojnë atë si të lehtë dhe nxënës të tjerë e zgjedhin, sepse planifikojnë të vazhdojnë arsimin e lartë për shkenca shoqërore.

Rezultatet e nxënësve në provimet e maturës tregojnë se të gjitha lëndët përgjithësisht i përmbushin kriteret e kurrikulës, sa u përket të tria niveleve të performancës. Megjithatë, është vërejtur aftësia e pamjaftueshme e mësuesve për t'iu dhënë nxënësve të gjitha mundësitë, që të përfitojnë sa më shumë të jetë e mundur nga procesi i të nxënësve dhe për të zbatuar kriteret e vlerësimit në procesin e mësimdhënies

dhe të nxënit, i cili ndikon ndjeshëm në cilësinë e performancës së nxënësve dhe të të gjithë sistemit.

4.4.6 Reflektime, opinione dhe sugjerime të prindërve

Qeverisja e institucioneve të arsimit, duke përfshirë shkollat, duhet të reflektojë dhe të promovojë vlerat e të drejtave të njeriut dhe të nxisë fuqizimin dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve, stafit arsimor dhe aktorëve të tjerë, duke përfshirë edhe prindërit⁶⁰. Në kuadër të procesit të decentralizimit të sistemit arsimor dhe qasjes së re të “shkollës si qendër komunitare”, **drejtuesit e shkollave kanë përgjegjësinë e vendosjes së komunikimit me prindërit e nxënësve dhe të krijimit të lidhjeve të forta me ta dhe me komunitetin.**

Përfshirja e prindërve nënkupton ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi me to, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit rreth rolit dhe pjesëmarrjes së tyre. Prindërit kanë rol shumë të rëndësishëm në arsimimin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe ky rol duhet të pasqyrohet saktësisht në veprimtarinë e tyre brenda sistemit arsimor.

Aktualisht, mësuesit, në bazë të shkollës, kanë të drejtë të zgjedhin, një nga tri tekstet alternative për çdo lëndë ose fushë. Ligji për arsimin parauniversitar, i vitit 2012, përfshinte përfshirjen e prindërve, në nivel shkolle, në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore, por ndryshimet e fundit në ligj, në vitin 2015, e kanë mënjeluar praninë e prindërve. **Në të vërtetë, përfshirja e prindërve mund të shërbejë për të rritur informimin e tyre rreth përmbajtjes së teksteve shkollore, për të kontribuar në përzgjedhjen e teksteve më të mira shkollore, si dhe për të përmirësuar rolin e tyre në plotësimin e rolit të mësuesve në përcjelljen e koncepteve të EQD-së dhe të EDNJ-së, të cilat janë në përputhje me ato të dhëna në shkollë.**

Bashkëpunimi në këtë drejtim, mund të kontribuojë në përmirësimin e bashkëpunimit mes mësuesve dhe prindërve sa u përket diskutimeve dhe shkëmbimeve të ideve, por edhe raportimit e adresimit të problematikave të fëmijëve.

Nga prindërit e intervistuar, u identifikuan si prindër shumë të përfshirë, ashtu edhe prindër indiferentë. Megjithatë, perspektiva e prindërve, sa u përket praktikave të mësimdhënies dhe të të nxënit është shumë e rëndësishme dhe veçanërisht e rëndësishme për EQD-në/EDNJ-në. Prindërit ndanë mendimet e tyre rreth mënyrave se si lëndët e EQD-së/EDNJ-së ndikojnë në qëndrimet e fëmijëve të tyre, rreth mënyrave se si e perceptojnë përmbajtjen e teksteve të caktuara shkollore dhe mënyrave të vlerësimit të performancës dhe rolit të mësuesve të këtyre lëndëve.

Në përgjithësi, **prindërit i japin rëndësi EQD-së dhe EDNJ-së dhe mendojnë se mësimi i koncepteve dhe praktikave të tyre duhet të ketë më shumë hapësirë në sistemin arsimor, sa u përket orëve të mësimdhënies, por edhe veprimtarive mbështetëse. Komentet negative lidheshin me përmbajtjen e teksteve shkollore dhe natyrën sipërfaqësore të dhënies dhe vlerësimit të detyrave të shtëpisë për lëndët e EQD-së dhe EDNJ-së.** Gjithashtu, sipas perceptimit të tyre, **tekstet shkollore nuk nxisin aftësinë e zgjidhjes së problemeve dhe të menduarin kritik mes fëmijëve dhe as mësimin ndërveprues e**

60. Karta e KiE-së për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për Edukimin për të Drejtat e Njeriut, seksioni 5.e.

përfshirës pa paragjykim dhe pa qasje diskriminuose. Në shumë tekste shkollore të lëndës së Qytetarisë janë marrë si shembuj të sjelljes së keqe situata të dhunshme, por pa u dhënë fëmijëve aftësitë për zgjidhjen e tyre. Edhe gjuha e përdorur në tekstet shkollore është shumë formale e skematike dhe nuk lejon një komunikim kuptimplotë të mesazhit të fëmijët. Në disa raste, prindërit folën edhe për lidhje jologjike mes dy fjalive. Këto konstatime përputhen me rezultatet e dala nga intervistat e prindërve në vitin 2012⁶¹. Ky është një tregues se gjendja e teksteve shkollore nuk është përmirësuar me kalimin e kohës.

Marrëdhënia nxënës-prindër-mësues është shumë e rëndësishme në krijimin e një mjedisi mësues pozitiv dhe të sigurt. Nxënësit, që ndihen pjesë e një komuniteti shkollor dhe kanë marrëdhënie të mira me prindërit e mësuesit e tyre, kanë më shumë gjasa të kenë rezultate më të larta mësimore dhe të ndihen më të plotësuar në jetën e tyre.⁶² Këtu përfshihet edhe marrëdhënia e prindërve me mësuesit, si dhe e mësuesit me prindërit.

Prindërit deklaruan se mbajnë komunikim të shpeshtë me fëmijët e tyre, e veçanërisht në këto ditë, që problemet sociale janë më të mprehta. Ata i udhëzojnë fëmijët e tyre mbi gjetjen e zgjidhjes së përshtatshme për ta. Por, prindërit e bëjnë këtë në mënyrë të pavarur nga shkolla dhe mësuesit. Procesi i zbatimit të kurrikulës është vendimtar për suksesin e saj dhe përfshin edhe angazhimin e komunikimin me mësuesit dhe prindërit.⁶³

Meqë prindërit janë bashkëpunëtorë të rëndësishëm, u ngrit pyetja nëse janë ftuar ato në trajtimin e problemeve sociale që mund të ketë klasa? Prindërit u përgjigjën qartë se ishin ftuar dhe se komunikimi me mësuesit është bërë në mënyrë periodike, por jo në mënyrë të strukturuar dhe efektive. Ata mendojnë se kanë statusin dhe mundësitë për të mbështetur mësuesit në diskutimin dhe adresimin e problemeve të ndryshme sociale ose në menaxhimin e situatave dhe çështjeve të vështira, pasi i njohin fëmijët e tyre më mirë nga disa këndvështrime të caktuara.

Si pjesë e analizës u shtrua edhe pyetja nëse prindërit janë përfshirë dhe ftuar në proceset e vendimmarrjes në nivel shkollor. *Raporti i monitorimit: alberteksti* (2012) nxori në pah se prindërit nuk u ftuan dhe nuk u përfshinë në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore edhe pse në atë periudhë përfshirja e tyre ishte një kërkesë e ligjit për arsimin parauniversitar.

Për sa i përket rolit të mësuesve, prindërit mendojnë se një mësues i mirë mund të bëjë punën e tij edhe pa një tekst shkollor. Sipas mendimit të tyre, teksti shkollor nuk është asnjëherë i mjaftueshëm dhe roli i mësuesit është shumë i rëndësishëm në përcjelljen e koncepteve dhe praktikave të EQD-së dhe të EDNJ-së. Të dyja palët, ***si prindërit ashtu edhe mësuesit kanë interes të përbashkët në shkëmbimin dhe ndarjen e pikëpamjeve, të informacionit dhe mendimeve në të mirë të fëmijëve.***

Në lidhje me mangësitë e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënësve për EQD-në/EDNJ-në, prindërit e intervistuar në kuadër të këtij raporti, identifikuan nevojën e

61. "Raporti i monitorimit: albertekst 2012", Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Soros).

62. Kuadri i Referencës i Kompetencave për Kulturë Demokratike; Udhëzues për zbatimin, vëllimi 3.

63. Rishikimi i politikës së arsimit në Shqipëri; Çështje dhe rekomandime, prill 2017.

trajtimit të problemeve sociale në mënyrë më të plotë, që do të thotë se kur flitet për *familjen*, koncepti duhet të pasurohet me elemente të rëndësishme, por edhe me problemet sociale të lidhura me emigrimin, divorcin, rrethanat ekonomike dhe problemet e tjera sociale aktuale. Përveç temave që përmban teksti shkollor, këshillohet përfshirja e diskutimeve, të tilla si: përdorimi i teknologjisë, risqeve dhe ekspozimit të lartë në hapësira virtuale, përfitimet e vullnetarizmit për nxënësit dhe komunitetin etj. ***Disa çështje të tjera që kërkojnë më shumë vëmendje dhe adresim lidhen me ushqyerjen dhe ushqimin e shëndetshëm, grupet e marginalizuara dhe qëndrimet e qytetarëve kundrejt tyre, abuzimin me substancat, dhunën në familje, abuzimin e fëmijëve, diskriminimin gjinor, bulizmin etj. Sipas prindërve, teksti shkollor i referohet një shoqërie ideale, kur në të vërtetë është e kundërta.***

Ndër çështjet sociale, që prindërit mendojnë se janë trajtuar siç duhet në tekstet shkollore, janë: bashkëjetesa në komunitet, mësimi i rregullave të trafikut për kalimtarët dhe makinat, përgjegjësia sociale, grupet sociale, rregullat e familjes dhe shkollës, simbolet kombëtare, ndikimi i ligjeve dhe rregullave në jetën sociale, të drejtat dhe liritë e minoriteteve.

Ndonëse kurrikula e lëndës së Qytetarisë bazohet në dimensionet politike, ligjore, kulturore, sociale dhe ekonomike, evropiane dhe globale, prindërit shprehën se përmbajtja e lëndës së qytetarisë nuk ndihmon për krijimin dhe zhvillimin e dijeve, aftësive dhe qëndrimeve të fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të përgjegjshëm.

Zgjidhja konstruktive e problemeve sociale është aftësi dhe komponent i rëndësishëm i modelit CDC. A i ndihmon teksti shkollor nxënësit të gjejnë zgjidhje për problemet sociale dhe ato rastësore? Prindërit janë skeptikë për këtë. ***Ata mendojnë se teksti shkollor i ndihmon nxënësit ta kuptojnë rregullin si koncept të ashpër, por nuk nxit të menduarin analitik dhe kritik se si situatat sociale mund të afrohen me rregullat dhe standardet qytetare.***

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1 PËRFUNDIME

Analiza, hulumtimi dhe intervistat e kryera me mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, me specialistët e arsimit dhe aktorët e tjerë dhe prindërit, kanë ndihmuar në nxjerrjen e përfundimeve të mëposhtme:

Ndryshimet e miratuara të kurrikulës shënojnë progres dhe janë në përputhje me politikat dinamike të KiE-së të njëzet vjetëve të fundit. Kurrikula e shkruar pasqyron konceptet dhe praktikat e përditësuara të dokumenteve të KiE-së. Kurrikula e lëndëve të Qytetarisë, Sociologjisë dhe Filozofisë është në përputhje dhe harmoni me konceptet, praktikat dhe pritshmëritë e KiE-së për EQD-në dhe EDNJ-në, pasi përfshijnë konceptet e parashtruara në Kartën e KiE-së.

Ekzistojnë disa faktorë që pengojnë zbatimin e saktë të kurrikulës. Konkretisht, cilësia e përmbajtjes së teksteve shkollore dhe mënyra e pasqyrimin të programit mësimor, nga disa tekste shkollore të ndryshme, nuk është e kënaqshme. Pyetjet dhe detyrat e teksteve shkollore janë të përgjithshme e nuk nxisin diskutimet që bazohen në të menduarin analitik ose kritik, si dhe nuk janë hartuar për të trajtuar kategori të ndryshme nxënësish. Parimi i barazisë gjinore është trajtuar në mënyrë sipërfaqësore, pasi tekstet shkollore u referohen ende roleve tradicionale gjinore.

Gjithashtu, mësuesve u nevojitet të kryejnë më shumë trajnime sa i përket përmbajtjes, por edhe zbatimit të teknikave të duhura të mësimdhënies dhe të të nxënës, si dhe përmirësimit të metodave efektive të vlerësimit. Mësuesit duhen trajnuar, gjithashtu, edhe për përdorimin e qasjes me në qendër nxënësin dhe punën e bazuar në projektet e të nxënës aktiv.

Nevoja e mësuesve për t'u trajnuar dhe për të përditësuar metodat e reja të mësimdhënies dhe të të nxënës, doli, gjithashtu, në pah nga përgjigjet e mbledhura nga nxënësit. Nxënësit pohuan qartë se duhet të përfshihen në detyra dhe projekte kreative, që nxisin aftësitë kërkimore dhe ato prezantuese, si në nivel individual ashtu dhe në ekip.

Sa i përket cilësisë së teksteve shkollore, pjesëmarrja e një game të gjerë aktorësh në hartimin e tyre, ka rritur konkurrencën dhe përgjegjësinë e botuesve për furnizimin e tregut me libra cilësorë. Gjithashtu, kjo bëri që mësuesit të jenë më të vetëdijshëm për programin dhe të rishikojnë me kujdes tekstet, pasi atyre iu dha hapësirë për të përzgjedhur tekstet shkollore, që, sipas tyre, ishin më të mirat për nivelet e nxënësve të tyre. Megjithatë, personat që i kundërshtuan këto tekste alternative theksojnë se rreziku i mundësive të pabarabarta për nxënësit rritet, në rastet kur autorët e teksteve nuk janë specialistë të fushës. Sipas opinionit të tyre, në tekstet alternative në disa raste janë përfshirë autorë amatorë dhe joprofesionistë ose autorë me nivele

të përparuara e përvojë shumë të profesionale, por të papërshtatshme me lëndën e Qytetarisë.

Tekstet shkollore të lëndës së Qytetarisë përmbajnë koncepte të cilat janë të vështira për mosha të caktuara dhe janë të paqarta në shpjegimin e disa prej koncepteve që përmbajnë. Në të dyja rastet, nxënësit ndeshen me vështirësinë e marrjes së informacionit dhe të të kuptuarit të koncepteve. Gjithashtu, tekstet shkollore nuk nxisin aftësinë e zgjidhjes së problemeve dhe të menduarin kritik të fëmijët dhe as mësimin interaktiv e përfshirës pa paragjykime dhe pa qasje diskriminuese.

Me sa duket, autorët i përdorin standardet për barazinë gjinore në një mënyrë sipërfaqësore. Ndonëse autorët janë treguar të kujdesshëm në ruajtjen e roleve gjinore – sa u përket numrave dhe ilustrimeve – ata nuk kanë arritur të shmangin me sukses stereotipat gjinorë. Mësuesit kanë rolin më të madh në edukimin dhe socializimin e fëmijëve dhe në promovimin e barazisë gjinore.

Një tjetër përfundim lidhet me cilësinë e vlerësimit që bazohet te portofoli i nxënësit. Pavarësisht qëllimeve dhe qasjes gjithëpërfshirëse të vlerësimit të nxënësit në bazë të portofolit, mënyra se si mësuesit i projektojnë detyrat që do të vlerësohen përmes kësaj metode, rëndësia e pakët që ata i kanë dhënë kësaj metode në diskutime dhe në prezantimin e punëve të veçanta, si dhe bashkëpunimi i pamjaftueshëm i prindërve, ka ulur vlerën e kësaj metode vlerësimi ashtu dhe qëllimin e saj. Edhe vlerësimi i nxënësve përmes kësaj metode është i dobët dhe cilësia e punës së bërë nga nxënësi nuk ndikon në vlerësim.

Në kuadër të procesit të decentralizimit të sistemit arsimor dhe qasjes së re të “shkollës si një qendër komunitare”, drejtuesit e shkollave kanë përgjegjësinë e vendosjes së komunikimit me prindërit e nxënësve dhe të krijimit të lidhjeve të forta me komunitetin. Prindërit i japin rëndësi EQD-së dhe EDNJ-së e mendojnë se mësimi i koncepteve dhe i praktikave të EQD-së dhe EDNJ-së duhet të ketë më shumë hapësirë në sistemin arsimor, sa u përket orëve të mësimdhënies, por edhe veprimtarive mbështetëse. Komentet negative lidheshin me përmbajtjen e teksteve shkollore dhe natyrën sipërfaqësore të vlerësimit të detyrave të shtëpisë për lëndët e edukimit për qytetarinë demokratike dhe edukimit për të drejtat e njeriut.

Kur flitet për marrëdhënien nxënës-prindër-mësues, prindërit u përgjigjën qartë se ishin ftuar në komunikime me mësuesit dhe se këto takime janë kryer në mënyrë periodike, por jo në mënyrë të strukturuar e efektive. Prindërit besojnë se kanë status dhe mundësi për t’i mbështetur mësuesit në diskutimin dhe në adresimin e problemeve të ndryshme sociale ose në menaxhimin e situatave dhe çështjeve të vështira apo delikate, pasi i njohin më mirë fëmijët e tyre. Prindërit dhe mësuesit kanë interes të përbashkët në shkëmbimin dhe ndarjen e pikëpamjeve, informacioneve dhe mendimeve në të mirë të fëmijëve.

5.2 REKOMANDIME

Siç edhe është deklaruar disa vite më parë nga Kryeministri, edukimi ndërkulturor dhe ndërfaqetor është çështje me përparësi të lartë; e tillë është edhe për Këshillin e Evropës. Përveç kësaj, *ndërgjegjësimi dhe shprehja kulturore* është një ndër kompetencat kyçe të parashikuara si të këtualla në ligjin për arsimin parauniversitar. Të gjithë nxënësit duhet ta fitojnë këtë kompetencë, prandaj rekomandohet që Ministria e Arsimit dhe Sportit, me propozim të hartuesve të kurrikulës, ta përfshijë lëndën e Sociologjisë në kurrikulën bërthamë. Rekomandohet që lënda e Qytetarisë të mësohet që në arsimin parashkollor.

Duke pasur parasysh rolin e aktorëve të ndryshëm në nivele të caktuara, rekomandohet nxitja e partneritetit dhe e bashkëpunimit mes aktorëve, me qëllim maksimizimin e kontributeve të tyre. Përveç rolit të posaçëm të mësuesve, rekomandohet që prindërit, mësuesit e lëndëve të tjera dhe drejtuesit e shkollave të përfshihen më shumë në projektimin dhe organizimin e veprimtarive jashtëkurrikulare, duke i drejtuar nxënësit në detyra dhe projekte të ndryshme, duke nxitur punën në grup dhe duke i dhënë jetë qasjes së “shkollës si qendër komunitare”. Përfshirja e nxënësve është e pamjaftueshme dhe duhet të përmirësohet. Forcimi i rolit të qeverisë së nxënësve brenda shkollës, si dhe rritja e përfshirjes së nxënësve janë me rëndësi jetike.

Duke ditur që mësuesit duhet të trajnohen intensivisht sa i përket të kuptuarit të përmbajtjes, por edhe miratimit të metodave të duhura të mësimdhënies dhe të nxënësve dhe përmirësimit të metodave të vlerësimit efektiv, rritja e përfshirjes së aktorëve të tjerë, si prindërit dhe drejtuesit e shkollave, mund t'i kishte ardhur në ndihmë procesit të të nxënësve përmes projektimit, mbështetjes dhe zbatimit të veprimtarive jashtëkurrikulare që kontribuojnë ndjeshëm në pajisjen e nxënësve me njohuri, qëndrime dhe aftësi të qëndrueshme për EQD-në. Gjithashtu, rekomandohet rritja e mbështetjes për mësuesit në zbatimin e kurrikulës së re me bazë kompetencat. Mbështetja duhet të jepet përmes trajnimeve, infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, dhe është e lidhur me nivelin e financimit të sistemit arsimor në Shqipëri, i cili është aktualisht në nivele të pakënaqshme. Përveç kësaj, krijimi i materialeve të mësimdhënies nga autorët e teksteve shkollore do të japë një kontribut të madh.

Trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve të lëndëve të EQD-së/EDNJ-së, nga ASCAP-ja me qëllim aftësimin e tyre me teknika nxënësje dhe mësimdhëniesje me bazë kompetencat krijon, gjithashtu, mundësinë e promovimit të një kulture të nxënësve jetëgjatë për EQD-në/EDNJ-në dhe promovon modelet e qëndrueshme të të menduarit dhe të vepruarit, si pjesë e skemës konjitive të nxënësve. Trajnimi i mësuesve të lëndës së Qytetarisë për të kryer vlerësime efektive të nxënësve, është një faktor i rëndësishëm për plotësimin e kurrikulës të kësaj lënde dhe, si i tillë, është i nevojshëm.

Pyetjet dhe detyrat e teksteve shkollore duhet të jepen si detyrë shtëpie ose detyrë klase dhe nxënësve të angazhohen në veprimtari të pavarura kërkimore, në nxjerrjen e përfundimeve të mbështetura në fakte dhe në interpretimin e mendimit të tyre në bazë të këtyre përfundimeve. Kjo gjë nxit të menduarin analitik dhe kritik sapo nxënësi të zbulojë lidhjet e zakonshme të dukurive sociale ose të fakteve dhe situatave të tjera interesante. Rekomandohet që tekstet të vazhdojnë të jenë burimi kryesor i procesit të mësimin, veçanërisht kur cilësia e mësuesve, sidomos e atyre që japin lëndën e

Qytetarisë, është e niveleve të ndryshme, gjë që nuk garanton të njëjtin mësim për të gjithë nxënësit. Për këtë qëllim, cilësia e teksteve shkollore mbetet parësore.

Mësuesit këshillohen të përdorin burime të tjera alternative mësimore, kur vërehet mungesa e njohurive, koncepteve dhe temave të përcaktuara nga programi mësimor në një tekst të përzgjedhur ose kur ky tekst nuk përmbush rezultatet e mësimin. Sa u përket teksteve shkollore, lind nevoja e identifikimit dhe zhvillimit të një liste autorësh të kualifikuar tekstesh shkollore, të cilët, gjithashtu, kanë nevojë për trajnim. Rekomandohet bashkimi i autorëve të teksteve shkollore me mësuesit dhe me psikologët, në mënyrë që të garantohet përputhshmëria e përmbajtjes së teksteve shkollore me nivelin e kuptimit dhe të zhvillimit të nxënësve.

Ndonëse mësuesit kanë lirinë e eksplorimit të burimeve alternative të të nxënësve, si dhe të angazhimit të nxënësve në projekte dhe veprimtari, që përcjellin tek ato mesazhin e EQD-së dhe EDNJ-së në mënyrë më natyrore dhe të qëndrueshme, kjo liri nevojitet të mbështetet me trajnime që i shërbejnë këtij qëllimi.

Sa i përket anës gjinore, objektivat e strategjisë nuk do të kishin kuptim, nëse nuk do të ndiqeshin në mënyrë të përgjegjshme nga mësues të përkushtuar e të motivuar, të cilët e kuptojnë mirë rëndësinë e madhe psikologjike dhe sociale të edukimit të fëmijëve në bazë të barazisë. Ata duhet të reflektojnë mbi këto vlera, duke i zbatuar ato në praktikatat e mësimdhënies e të nxënësve dhe për ndryshimin e qëndrimeve vetjake. Është e rëndësishme që sjellja e mësuesve të orientohet drejt promovimit të vlerave të çdo nxënësi dhe jo drejt kuadrove stereotipike të vajzës ose të djalit.

Pasqyrimi stereotipik duhet të studiohet me kujdes e në mënyrë të detajuar, që të ofrojë perspektiva më asnjansë dhe karaktere të barabarta në rolet jotradicionale, por gjithsesi të përshtatshme me kontekstin social. Kujdes dhe vëmendje e posaçme duhet të kushtohet nga autorët dhe mësuesit, të cilët duhet t'i trajtojnë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe duhet të angazhohen në mënyrë aktive në eliminimin e çfarëdolloj elementi seksist. Ndërtimi i kapaciteteve që i përgjigjen një mendësie vizionare është dhe duhet të jetë detyra kyçe e sistemit arsimor.

Një tjetër element, që duhet përmirësuar, është monitorimi dhe vlerësimi i integritetit gjinor në shkolla nga autoritetet përkatëse, në përputhje me rekomandimin e KiE-së për integritetin gjinor në arsim.

Sa i përket përzgjedhjes së teksteve shkollore, përfshirja e prindërve mund të çojë në informim më të mirë të tyre rreth përmbajtjes së teksteve shkollore, të ndihmojnë në përzgjedhjen e teksteve më të mira shkollore, si dhe në rritjen e rolit të tyre në mbështetje të mësuesve për përcjelljen e koncepteve të *edukimit për qytetari demokratike* dhe të *edukimit për të drejtat e njeriut*, të cilat janë në përputhje me ato të dhëna në shkollë.




Pjesa më e madhe e rezultateve dhe përfundimeve, bazuar edhe në arsyetimin e rekomandimeve të mësipërme, mund të adresohen përmes trajnimeve sistematike të mësuesve. Trajnimi i mësuesve sjell rezultate të shpejta në përmirësimin e objektivave të të nxënësve dhe adreson, njëkohësisht, edhe pjesën më të madhe të problemeve të identifikuar.

6. LISTA E REFERENCAVE

- Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në kuadër të Rekomandimit KM/Rek. (2010) të Komitetit të Ministrave, gjendet në: <https://rm.coe.int/16803034e5>
- Rekomandimi Rek. (2002)12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për edukimin për qytetari demokratike; i miratuar nga Komiteti i Ministrave, më 16 tetor 2002, gjendet në: file:///D:/Users/Ada/Downloads/UNDP-TR-Recommendation_2002-12.doc.PDF
- Rekomandimi KM/Rek. (2012)13 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me sigurimin e cilësisë në arsim, gjendet në: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805c94f1
- Rekomandimi KM/Rek. (2007)13 për integrimin gjinor në arsim, i miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, më 10 tetor 2007, dhe memorandum i shpjegues, gjendet në: https://books.google.al/books/about/Gender_Mainstreaming_in_Education.html?id=osEYR8CX1D8C&redir_esc=y
- Rekomandimi KM/Rek. (2019)1 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për parandalimin dhe luftimin e seksizmit, gjendet në: <https://rm.coe.int/168093b26a>
- Këshilli i Evropës, Qeverisja Demokratike e Shkollave (2007), udhëzime për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave për miratimin e qeverisjes demokratike, gjendet në: <https://www.coe.int/en/web/campaign-free-to-speak-safe-to-learn/-/democratic-governance-of-schools-2007-guidelines-for-teachers-and-school-leaders-on-adopting-a-democratic-governance-and-whole-school-approach->
- Manuali i Këshillit të Evropës për Mësuesit: Demokracia në Veprim, gjendet në: <https://www.coe.int/en/web/edc/living-democracy-manuals>
- Krijimi i një Evrope për fëmijët dhe me to, si dhe pa gjuhë urrejtjeje, gjendet në: <https://www.coe.int/en/web/no-hate-campaign>, si dhe <https://www.coe.int/t/dg3/children/>
- Kompetencat për Kulturë Demokratike, të jetojmë së bashku si të barabartë në shoqëri demokratike kulturalisht të ndryshme, Këshilli i Evropës, gjendet në: <https://rm.coe.int/16806ccc07>
- Platforma për vetëreflektimin e mësuesve e KRKKD-së, gjendet në: <https://www.coe.int/en/web/reference-framework-of-competences-for-democratic-culture/-reflection-tool-for-teachers>
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 69/2012 “Për arsimin parashkollor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

- Vendimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 47/2019 “Për miratimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 11.1.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për periudhën 2014–2020”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar”
- Urdhri i ministrit të Arsimit nr. 155, datë 22.4.2015, i ndryshuar me urdhrin e ministrit të Arsimit nr. 640, datë 13.12.2017, “Për miratimin e standardeve për librat shkollore”
- Udhëzuesi i MAS-it nr. 34, datë 11.9.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca në arsimin bazë”
- Vlerësimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014–2020, MAS, mbështetur nga UNICEF-i, UNICEF-i, gusht 2020, gjendet në: <https://www.unicef.org/albania/>
- Analiza e situatës së arsimit në Shqipëri: Drejt OZHQ4 – Arsimi 2030, UNESCO, 2018
- “Raporti i monitorimit: altertekt”, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Soros), 2012

Për më tepër informacion:

-  <https://www.coe.int/sq/web/tirana/home>
-  Council of Europe Office in Tirana
-  coe_tirana

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE